# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5491
E premte, 1 qershor 2018
çmimi 0.40 €


## Ministri Ismaili kërkon që Ligji për Duhanin të zbatohet në tërësi

FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", KRESHNIK GASHI FAQE 4-5

# Kriza në Telekom shtyri implementimin e kodit +383



Kryetari i Bordit të Agjencisë për Komunikime Postare dhe Elektronike (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka bërë me dije se deri më tani ka pasur mjaft progres në drejtim të implementimit të kodit shtetëror telefonik +383 nga operatorët, por hapi final i largimit të kodeve aktuale nuk është arritur të bëhet ashtu siç është paraparë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë drejtim kanë ndikuar problemet financiare dhe teknike të operatorëve, me theks të veçantë në Telekomin e Kosovës. "Problemet financiare të Telekomit të Kosovës kanë qenë edhe baza kryesore për shtyrje të afatit të datës 1 qershor", ka thënë ai. Gashi shpreson që Telekomi i Kosovës të dalë shpejt nga kjo krizë dhe t'i kryejë investimet e nevojshme sa i përket kodit +383. Ai ka treguar se ARKEP-i aktualisht është në proces të punës për domenin shtetëror të internetit

## Javën e ardhshme nis lobimi për vizat në BE

Nga java e ardhshme Kuvendi i Kosovës do të nisë një ofensivë diplomatike nëpër kryeqendrat e Bashkimit Evropian për ta kërkuar mbështetjen për liberalizim të vizave. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka treguar se në këtë turne përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës do t'i garantojnë vendet anëtare të BE-së se qytetarët e Kosovës do t'i respektojnë plotësisht procedurat që parasheh programi i lëvizjes së lirë në Zonën Shengen FAQE 3





## Kuvendi debaton të hënën për platformën e dialogut me Serbinë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e së hënës do ta shqyrtojnë projekt-platformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Kjo platformë synim kryesor ka arritjen e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut FAQE 5

### AKTUALE

PËR XHEMËN QË NA MUNGON F. 11



MIMOZA KELMENDI

HARADINAJ: XHEMAJL FETAHAJ, SHEMBULL I LUFTËTARIT DHE PATRIOTIT SHQIPTAR F. 11

KUVENDI MIRATON REZOLUTAT DHE REKOMANDIMET E NXJERRA NGA SEANCAT E MËPARSHME F. 5

### EKONOMI

LANSOHET SOFTUERI PËR CILËSINË E AJRIT F. 8

ODA AMERIKANE BËN THIRRJE PËR DIALOG MË TË FUQISHËM PUBLIKO-PRIVAT F. 8

### KULTURË

INSTITUTI ITALIAN I KULTURËS SHTRIHET EDHE NË PRISHTINË F. 13

### SPORT

KATËR GJIMNASTE PREZANTOJNË KOSOVËN NË ITALI F. 18

PRISHTINA PREZANTON THAQIN DHE BEKTESHIN F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Dy propozime për emrin e Maqedonisë

Pas disa raunde negociatash në Shkup, Athinë, Bruksel dhe, së fundmi, në Nju Jork, palët ranë dakord për dy nga pesë emrat e propozuar nga kryenegociatori Methju Nimic- "Maqedonia e Sipërme" dhe ajo veriore



SHKUP, 31 MAJ - Maqedonisë i ka mbetur shumë pak kohë për të gjetur një zgjidhje për çështjen e emrit me Greqinë, çështje e cila do t'ia hapte rrugën për anëtarësimin në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Pas disa raunde negociatash në Shkup, Athinë, Bruksel dhe, së fundmi, në Nju Jork, palët ranë dakord për dy nga pesë emrat e propozuar nga kryenegociatori Methju Nimic: "Maqedonia e Sipërme" dhe ajo veriore.
Pala greke ka kërkuar që emri i ri i të jetë një term që do të përdoret nga të gjithë në kontekstin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, gjë e cila është kundërshtuar nga presidenti maqedonas Gjorge Ivanov. Në një deklaratë për shtyp të zyrës së presidentit, theksohet se ai nuk pranon një zgjidhje që do ta sillte ndryshimin e emrit të Maqedonisë brenda vendit, as ndryshimin e Kushtetutës. "Qëndrimi i presidentit Ivanov është parimor, njëherësh konsistent me qëndrimet e deritanishme të presidentëve të Republikës së Maqedonisë. Presidenti Ivanov nuk pranon zgjidhje për çështjen e emrit që do ta sillte ndryshimin për përdorim të përgjithshëm, por as ndryshim të Kushtetutës", thuhet në njoftimin e zyrës së Ivanovit.
Ivanovi pritet të zhvillojë një takim me ministrin e Jashtëm Nikolla Dimitrov për të biseduar për çështjen e emrit, pavarësisht se bisedimet në nivel teknik kanë përfunduar dhe dy kryeministrat Zoran Zaev e Aleksis Cipras pritet ta japin vendimin përfundimtar.
Duke iu përgjigjur deklaratës së presidentit Ivanov, në një deklaratë për shtyp përcjellë nga zyra e kryeministrit grek, theksohet se "Zgjidhja dhe anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe BE kërkon një marrëveshje për një emër të përbërë, që do të zbatohet nga të gjithë dhe kërkon një ndryshim kushtetues".
Një ditë më parë kryeministri Zoran Zaev tha se Shkupi dhe Athina kanë arritur një marrëveshje për çështjen e emrit, por pa zbuluar propozimin aktual që është në tavolinë.
Ai tha se në rast se gjen gjuhën e përbashkët me homologun grek, Cipras, qytetarët e Maqedonisë do t'i drejtohen votimit me referendum për të vendosur përfundimisht për emrin në muajin shtator ose tetor.

LAJME SHKURT

## Presidenti Thaçi ka udhëtuar për në Londër



PRISHTINË, 31 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me ftesë të Universitetit prestigjioz të Oksfordit, ka udhëtuar për në Londër, ku para një publiku të zgjedhur do të mbajë një ligjëratë me temën "Kosova dhe rruga drejt pavarësisë".
Presidenti Thaçi, po ashtu, do të zhvillojë disa takime me miq të Kosovës, që në të kaluarën kanë mbështetur rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Ndërkaq, gjatë qëndrimit në Vjenë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar tenorin dhe dirigjentin më të njohur në botë nga Spanja, Plácido Domingo. Në profilin e tij në "Facebook", Thaçi ka shkruar se ka ftuar tenorin spanjoll që ta vizitojë Kosovën në një të ardhme të afërt. "Përveç bisedës së këndshme, tenorin e njohur Domingo e ftova ta vizitojë Kosovën, ftesë të cilën e pranoi me shumë kënaqësi", ka shkruar Thaçi. "Në Vjenë takova tenorin dhe dirigjentin me famë botërore nga Spanja, Placido Domingo. Përveç bisedës së këndshme, tenorin e njohur Domingo e ftova ta vizitojë Kosovën, ftesë të cilën e pranoi me shumë kënaqësi", ka shkruar Thaçi në "Facebook".

## Deputeti gjerman, pro hapjes së negociatave për Shqipërinë



TIRANË, 31 MAJ - Deputeti i SPD-së në Bundestagun gjerman, Metin Hakverdi, anëtar i Komitetit për Çështjet e Bashkimit Evropian në Bundestag, po zhvillon një vizitë në Shqipëri, ku ka pasur një takim me kreun e grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, ndërsa ka ndjekur edhe seancën e sotme plenare.
Në një prononcim për mediet jashtë Kuvendit, Hakverdi tha se "duam të kemi progres sa i përket zgjerimit të BE-së. Jemi dakord për këtë proces dhe kemi qenë dakord për shumë kohë". "Procesi i zgjerimit nuk është vetëm në favor të Shqipërisë, por të gjithë Bashkimit Evropian. Jam optimist jo vetëm për hapjen e negociatave, por edhe për progresin e mëtejshëm", tha Hakverdi.
Ndërsa Balla u shpreh se "SPD gjermane, pjesë e koalicionit qeverisës së Gjermanisë, që drejton disa ministri, është një mbështetëse e madhe e procesit të zgjerimit të mëtejshëm në BE, por ajo që është më e rëndësishme për ne është që social-demokratët gjermanë mbështesin hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe një vendim pozitiv të Këshillit Evropian më 28 qershor".

## Kryemadhi: Koha e Edi Ramës është drejt fundit



Tiranë, 31 maj - Për herë të parë Parlamenti i Shqipërisë nuk është bojkotuar nga opozita, por nga mazhoranca. Të enjten, pas tensioneve mes PS-së dhe opozitës, kryeministri Edi Rama dhe deputetët e selisë rozë u larguan nga salla e seancave. Bashkë me ikjen e deputetëve nga salla e Kuvendit u urdhërua dhe largimi i medieve që raportojnë aktivitetin parlamentar. Deputetët e opozitës kanë vijuar "seancën" duke bërë transmetime në "Facebook" nga salla e Kuvendit.
Në fjalën e saj, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u shpreh se zgjidhja e krizës politike është largimi i kryeministrit Edi Rama. Kryemadhi tha se shqiptarët nuk e duan më këtë Qeveri dhe se "Rama do të mbetet vetëm me kriminelët e tij".
Kryetarja e LSI-së paralajmëroi se qeverisja e Edi Ramës është drejt fundit. "Kemi detyrim ndaj shqiptarëve, por edhe socialistëve, që u mashtruan nga Rama. Sot ne duhet të jemi më të qartë se kurrë për t'i thënë Ramës dhe kriminelëve të tij se ata janë vetëm. Shqiptarët janë të gjithë ata burra dhe gra, pensionistë, djem e vajza, që luftojnë çdo ditë për bukën e gojës dhe për të pasur një vend pune, një jetë më të mirë. Rama i do shqiptarët të varfër, të kapur, sepse vetëm kështu ai mund të mbretërojë në mbretërinë e krimit. Rama nuk ka kuptuar ende që koha e tij është drejt fundit, se nuk ka më asnjë njeri që ta mbrojë. Ndihet i fortë për paratë që ka për të paguar televizione, por shqiptarët nuk i blen dot", tha Kryemadhi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi i Kosovës aktivizon diplomacinë parlamentare

# Javën e ardhshme nis lobimi për vizat në BE

Nga java e ardhshme Kuvendi i Kosovës do të nisë një ofensivë diplomatike nëpër kryeqendrat e Bashkimit Evropian për ta kërkuar mbështetjen për liberalizim të vizave. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka treguar se në këtë turne përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës do t'i garantojnë vendet anëtare të BE-së, se qytetarët e Kosovës do t'i respektojnë plotësisht procedurat që parasheh programi i lëvizjes së lirë në Zonën Shengen



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije të enjten se nga java e ardhshme, së bashku me përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës, do të fillojnë një turne lobimi në qendrat kryesore evropiane për liberalizimin e vizave. Ai ka treguar se gjatë këtij turneu do t'i garantojnë vendet anëtare të BE-së se qytetarët e Kosovës do t'i respektojnë plotësisht procedurat që parasheh programi i lëvizjes së lirë në Zonën Shengen. "Nga java e ardhshme, i shoqëruar edhe nga përfaqësuesit e partive politike në Kuvendin e Kosovës, pozitë dhe opozitë, do të fillojë një turne lobimi në qendrat evropiane, për ta kërkuar mbështetjen për liberalizim, po ashtu për të garantuar se qytetarët tanë do t'i respektojnë plotësisht procedurat që parasheh programi i lëvizjes së lirë në Zonën Shengen", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Javën e kaluar gazeta "Epoka e re" ka shkruar se institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin një fushatë lobuese nëper kryeqendrat e Bashkimit Evropian (BE) për procesin e liberalizimit të vizave. Njohësit e integrimeve evropiane patën deklaruar se qendrave të BE-së në mënyrë të qartë dhe të matshme duhet t'u komunikohet progresi i arritur në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

Njohësi i integrimeve evropiane, Taulant Kryeziu, kishte deklaruar për "Epokën e re" se një fushatë e tillë është shumë e nevojshme ngaqë, sipas tij, duhet pasur parasysh se ka mungesë të entuziazmit brenda shteteve anëtare për liberalizimin e vizave me vendet e treta. Ai ka vlerësuar se ky është një proces teknik me vendimmarrje politike që rol kyç do të kenë shtetet kryesore anëtare të BE-së. "Mjedisi politik në kuadër të vendeve anëtare në vitin 2018 nuk është mjedis politik i vitit 2012 kur është lansuar procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën. Vitet e fundit vendet anëtare janë ballafaquar me presion të fuqishëm publik për heshtjet siç janë migrimi, azilkërkuesit, terrorizmi etj. Po ashtu, ka pasur ide për suspendim të regjimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor që tashmë kanë fituar liberalizimin e vizave. Prandaj, duhet nënvizuar se Kosova ballafaqohet me një mjedis negativ publik dhe politik për liberalizimin e vizave. Vendet anëtare të rëndësishme, siç janë Franca, Suedia, Holanda, kanë shfaqur rezerva të mëdha për heqjen e regjimit të vizave për Kosovën", ka thënë Kryeziu.

Për këto arsye, sipas Kryeziut, institucionet e Kosovës duhet të komunikojnë me vendet anëtare të BE-së dhe t'ua tregojnë progresin që është arritur. "Konsideroj se duhet të lobohet në kryeqytetet e vendeve anëtare të BE-së dhe t'u komunikohet në mënyrë të qartë dhe të matshme progresi i arritur në Kosovë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave. Në veçanti, vendeve anëtare duhet t'u komunikohen masat që Kosova ka marrë në fushën e azilkërkuesve, migrimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këto janë temat e interesit vital për vendet anëtare", është shprehur Kryeziu.

Më herët edhe opozita ka ftuar Qeverinë e Kosovës të punojë me vendet që janë skeptike rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. "Rekomandimi do të qartësohet, por data do të vijë nga Këshilli i Ministrave dhe në këtë rrafsh duhet të punojmë shumë me presidentin Donald Tusk dhe me shtetet që nuk e pranojnë pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, kemi edhe numër të shteteve që kanë hezitime serioze në këtë çështje", kishte thënë nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri.

Liderët politikë të vendit kanë paralajmëruar se vendimmarrja e institucioneve të BE-së për liberalizim të vizave për Kosovën pritet të fillojë në pjesën e dytë të muajit qershor. Sipas tyre, qëndrimi unanim i BE-së është se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizim të vizave. Kohë më parë Komisioni Evropian ka dërguar një grup të ekspertëve në Kosovë për ta parë nga afër përmbushjen e këtyre kritereve. Ky komision do të hartojë një raport të cilin do t'ua dorëzojë institucioneve të BE-së.

# Ministri Tahiri: Liberalizimi i vizave i jep fund izolimit



PRISHTINË, 31 MAJ - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të enjten në takim deputetet e Bundestagut gjerman, Katja Keul dhe Filiz Polat, të cilat kanë qenë të shoqëruara nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Chirstian Heldt.

Tahiri ka theksuar se prioritet në punën e tij ka pasur përmbushjen e kushteve për liberalizimin e vizave, duke u angazhuar në forcimin e legjislacionit për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Për Kosovën dhe qytetarët e saj, liberalizimi i vizave nënkupton dy gjëra: një hap përpara në procesin e integrimit evropian dhe krijimin e një platforme për t'i dhënë fund izolimit dhe ua jep qytetarëve tanë mundësinë e zgjerimit të pikëpamjeve të tyre, duke u takuar dhe duke njohur kultura të tjera, duke njohur nga afër vlerat evropiane" ka thënë Tahiri.

Më tutje, ai ka përmendur punën që është bërë në pakon e ligjeve për gjyqësorin dhe pakon kundër korrupsionit, duke theksuar se për të gjitha këto ligje janë angazhuar ekspertë të shumtë. "Liberalizimi i vizave nënkupton se Kosova ka dëshmuar se ka kapacitet për arritjen e rezultateve konkrete për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, që në fund nënkupton jetë më të mirë për qytetarët tanë, gjyqësor më të fuqishëm dhe më efikas dhe respekt absolut për të drejtat njerëzore", ka deklaruar Tahiri.

Ai ka njoftuar delegacionin gjerman edhe për ndryshimet në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Civil, si dhe ligjet e tjera të nxjerra nga Agjenda e Reformave Evropiane.

Flet për "Epokën e re", Kreshnik Gashi

# Kriza në Telekom shtyri implementimi




**Kryetari i Bordit të Agjencisë për Komunikime Postare dhe Elektronike (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka bërë me dije se deri më tani ka pasur mjaft progres në drejtim të implementimit të kodit shtetëror telefonik +383 nga operatorët, por hapi final i largimit të kodeve aktuale nuk është arritur të bëhet ashtu siç është paraparë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë drejtim kanë ndikuar problemet financiare dhe teknike të operatorëve, me theks të veçantë në Telekomin e Kosovës. "Problemet financiare të Telekomit të Kosovës kanë qenë edhe baza kryesore për shtyrje të afatit të datës 1 qershor", ka thënë ai. Gashi shpreson që Telekomi i Kosovës të dalë shpejt nga kjo krizë dhe t'i kryejë investimet e nevojshme sa i përket kodit +383. Ai ka treguar se ARKEP-i aktualisht është në proces të punës për domenin shtetëror të internetit**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 MAJ - Kryetari i Bordit të Agjencisë për Komunikime Postare dhe Elektronike (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka konfirmuar se problemet financiare të Telekomit të Kosovës kanë qenë baza kryesore për shtyrje të afatit të datës 1 qershor të implementimit të kodit të ri shtetëror telefonik +383. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se ARKEP-i në aspektin rregullativ ka bërë të gjitha përgatitjet për implementimin me kohë të kodit shtetëror telefonik të ndarë nga ITU +383. "ARKEP-i në vazhdimësi ka marrë raporte për progresin e implementimit të kodit, por në muajt e fundit janë vërejtur disa ngecje dhe përfundimisht operatori Telekomi i Kosovës, por edhe operatori IPKO, për arsye të ndryshme nga Telekomi, kanë kërkuar një afat shtesë për largimin e kodeve aktuale, të cilat kërkesa pas analizimit i ka pranuar si të arsyeshme Bordi i ARKEP-it dhe si rezultat ka dhënë një datë të re për largim të kodeve aktuale", ka thënë Gashi. Ai ka treguar se ARKEP-i aktualisht është në proces të punës për domenin shtetëror të internetit. Gashi ka theksuar se aktualisht në Republikën e Kosovës nuk ka operatorë ilegalë në telefoninë mobile dhe fikse. Ai ka bërë me dije se ARKEP-i përballet me disa sfida specifike, që janë kryesisht si rezultat i mungesës së një pavarësie financiare dhe numrit të vogël të stafit.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, cilat janë arsyet e shtyrjes së implementimit të kodit telefonik +383?*

**Gashi:** Me gjithë faktin se ARKEP-i në aspektin rregullativ ka bërë të gjitha përgatitjet për implementimin me kohë të kodit shtetëror telefonik të ndarë nga ITU +383, zbatimi teknik, përkatësisht migrimi nga kodet aktuale në kodin e ri +383, është një proces që u takon vetë operatorëve të telekomit ta kryejnë. Mund të themi se deri më tani ka pasur mjaft progres në drejtim të implementimit të kodit +383 nga operatorët por, megjithatë, hapi final i largimit të kodeve aktuale plotësisht nuk është arritur të bëhet me kohë ashtu siç e kemi paraparë, kryesisht për shkak të problemeve financiare dhe teknike respektivisht, të operatorëve, me theks të veçantë në Telekomin e Kosovës. ARKEP-i në vazhdimësi ka marrë raporte për progresin e implementimit të kodit, por në muajt e fundit janë vërejtur disa ngecje dhe përfundimisht operatori Telekomi i Kosovës, por edhe operatori IPKO për arsye të ndryshme nga Telekomi, kanë kërkuar një afat shtesë për largimin e kodeve aktuale, të cilat kërkesa pas analizimit i ka pranuar si të arsyeshme Bordi i ARKEP-it dhe si rezultat ka dhënë një datë të re për largim të kodeve aktuale.

**"Epoka e re":** *Po gjendja financiare me të cilën përballet Telekomi i Kosovës, si mund të reflektojë në këtë aspekt?*

**Gashi:** Me gjithë faktin se ARKEP-i është rregullator i tregut dhe në bazë të ligjit nuk mund të bëjë asnjë diskriminim apo trajtim ndryshe të operatorëve në treg si dhe nuk mund të ndërhyjë në menaxhimin e brendshëm të operatorëve, mund të them se gjendja aktuale financiare e Telekomit të Kosovës është shumë shqetësuese, si dhe si Autoritet ne kemi pasur mirëkuptim maksimal për të gjitha kërkesat e Telekomit të Kosovës gjatë gjithë mandatit të bordit aktual e, po ashtu, mund të shtojë se problemet financiare të Telekomit të Kosovës kanë qenë edhe baza kryesore për shtyrje të afatit të datës 1 qershor. Megjithatë, shpresojmë se Telekomi i Kosovës të dalë shpejt nga kjo krizë dhe t'i kryejë investimet e nevojshme. Ta kemi parasysh se investimi në largimin e kodeve të huaja

# in e kodit +383



në çdo rast në një të ardhme të afërt do të kthehet mbrapa shumëfish më shumë te kompania, nëpërmjet përfitimit që ajo do të ketë si rezultat i shfrytëzimit të kodit të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Me kodet telefonike +377 dhe +386, si do të veprohet tani?*

**Gashi:** Kodet aktuale, përkatësisht numeracioni i përdorur me këto prefikse, do t'u kthehen në shfrytëzim vendeve nga ku janë marrë për shfrytëzim, përkatësisht Monakos dhe Sllovenisë. Por kjo nuk do të thotë se do të ketë ndryshime në numeracionin e brendshëm që përdoret në Kosovë, struktura e numrave për telefoni mobile dhe fikse do të mbetet e njëjtë, vetëm prefiksi ndërkombëtar, përkatësisht kodi shtetëror do të ndërrojë.

**"Epoka e re":** *Çfarë humbjesh mund t'i shkaktojë Kosovës mosimplementimi nga 1 qershori, siç ishte paralajmëruar?*

**Gashi:** Humbja e vetme është shfrytëzimi edhe për këtë periudhë i kodeve të huaja dhe pagesat nga kompanitë tona për përdorim të kodeve të huaja. Pas kalimit në shfrytëzim të kodit të Kosovës +383, operatorët tanë nuk do të kenë nevojë të paguajnë për përdorimin e kodeve të huaja në thirrjet ndërkombëtare.

**"Epoka e re":** *Si qëndron puna me operatorët ilegalë në Kosovë dhe sa është arritur të parandalohet veprimtaria e tyre?*

**Gashi:** Aktualisht në Republikën e Kosovës nuk ka operatorë ilegalë në telefoninë mobile dhe fikse. Për të ardhur deri në këtë situatë është dashur shumë kohë dhe kalimi nëpër procese shumë komplekse. Stafi i ARKEP-it, i mbështetur edhe nga Policia e Kosovës, me shumë dedikim ka arritur t'i kryejë matje dhe të largojë përfundimisht në mars të vitit të kaluar edhe nga veriu i Kosovës operimet ilegale që kanë ekzistuar atje dhe në pjesë të tjera të Kosovës që nga pas lufta.

**"Epoka e re":** *Sa janë të hyrat e ARKEP-it nga janari deri më tani, dhe si është raporti me vitin e kaluar?*

**Gashi:** Të hyrat për vitin 2018 për ARKEP-in nga taksat e ndryshme janë paraparë të jenë rreth 3.75 milionë euro, ndërsa deri më tani janë realizuar rreth 1.8 milion, përkatësisht 48 % e të hyrave të planifikuar për vitin 2018.

**"Epoka e re":** *Me cilat sfida po përballeni?*

**Gashi:** ARKEP-i përballet me disa sfida specifike, që janë kryesisht si rezultat i mungesës së një pavarësie financiare, numrit të vogël të stafit. Po ashtu, si shumë institucione publike të Kosovës që rregullojnë sektorë që kanë nevojë për shumë shkëmbime në nivel global, pamundësia për të marrë pjesë në disa forume që kanë për bazë anëtarësimin e shteteve në Kombet e Bashkuara është duke shkaktuar probleme në një funksionim më të mirë. Ne si institucion kemi raporte shumë të mira bashkëpunimi bilateral më shumë homologë tanë nga vende të ndryshme partnere, por ende nuk jemi anëtarë në trupa multilateralë me rëndësi për telekomin si ITU, BEREC, IRG etj. Aktualisht jemi në proces të punës për domenin shtetëror të internetit, të cilin, fatkeqësisht, Kosova ende nuk e ka, dhe edhe te ky rast na janë shfaqur shumë sfida si rezultat i rrethanave që u thanë më sipër.

# Kuvendi miraton rezolutat dhe rekomandimet e nxjerra nga seancat e mëparshme

EPOKA E RE — A. MAVRAJ

**Prishtinë, 31 maj** - Kuvendi i Kosovës ka votuar të enjten rezolutat dhe rekomandimet e nxjerra nga debatet e mbajtura ditë më parë. Me 90 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim është votuar rezoluta e nxjerrë nga debati parlamentar i thirrur nga Partia Social Demokrate (PSD) lidhur me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave.

Përmes kësaj rezolute Kuvendi i Kosovës kërkon rritjen e buxhetit dhe ngritjen e kapaciteteve për sektorin e drejtësisë për Këshillin Prokurorial dhe atë Gjyqësor të Kosovës, kërkon nga organet e drejtësisë të jenë më efikase për zgjidhjen e rasteve që lidhen me krim të organizuar dhe korrupsionit, si dhe kërkohet nga Qeveria që brenda vitit të hartohen projektligje që forcojnë masat për luftën kundër korrupsionit.

Me 70 vota për janë miratuar edhe rekomandimet nga debati parlamentar, në lidhje me sigurinë e fëmijëve për përdorimin e internetit në Kosovë.

Obligimi i Qeverisë për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, trajnimet për mësimdhënësit, hartimi i rregulloreve, sanksionim me ligj për shantazhimin e fëmijëve në rrjete sociale ishin vetëm disa nga rekomandimet e votuara.

Në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës është miratuar edhe rezoluta e iniciuar nga Lëvizja Vetëvendosje në lidhje me sektorin e Energjetikës dhe Termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B". Kjo rezolutë parasheh që Qeveria brenda dy javëve në bashkëpunim me menaxhmentin e Korporatës Elektroenergjitike ta hartojë planin e masave për reagimin emergjent dhe afatgjatë në sigurimin e prodhimit të energjisë; Zyra e Rregullatorit të Energjisë të mos pranojë kërkesa për rritjen e çmimit të energjisë nga kompania KEDS-KESCO; Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë sa më i shpejtë rindërtimin e Termocentralit "Kosova A"; Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me KEK-un ta përshpejtojë planin e remontit të Termocentralit "Kosova B"; KOSTT ta realizojë kontraktimin e energjisë elektrike me Shqipërinë për periudhë afatgjatë; dhe Qeveria të marrë masa urgjente dhe t'i aplikojë ato për stabilizimin e prodhimit të qymyrit - sanimi i ndërtimit të kundërligjshëm në Shipitullë.

Në këtë seancë, po ashtu, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar propozimvendimin e Qeverisë për emërimin e gjashtë anëtarëve të bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ky propozim ka kaluar me 46 vota për dhe 18 kundër. Anëtarët e emëruar të bordit të APK-së janë: Hasime Mazreku, Skënder Komoni, Qemajl Behrami, Ranko Djokiq, Bekim Selimaj dhe Avni Ajdini.

## Haradinaj e Kurti përplasen ashpër në Kuvend

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kanë zhvilluar debat të ashpër në seancën e së enjtes në Kuvend me akuza e kundërakuza. Fillimisht Kurti ka thënë se Haradinaj është i pafuqishëm ngaqë përfaqëson një Qeveri të pakicës dhe se, sipas tij, një kryeministër që ka performancë kaq të dobët nuk mund ta bashkojë Mitrovicën edhe përkundër premtimeve. "Për bindjen time të fuqishme, pavarësisht prej premtimeve të kryeministrit aktual, ato nuk do të realizohen për shkak që kryeministri Haradinaj është në një pozitë jashtëzakonisht të dobët, ka një Qeveri të pakicës me 52 deputetë ku partia e kryeministrit nuk e ka as çerekun e tyre. Një kryeministër që ka një performancë kaq të dobët nuk mund të na e bashkojë Mitrovicën të na integrojë veriun e ta bëjë faturimin atje", ka thënë Kurti. Pas këtyre kritikave, i menjëherëshëm ka qenë reagimi i kryeministrit Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Qeveria që udhëheq është mjaft e angazhuar në punë duke ia përmendur Kurtit Ligjin për Prishtinën. "Tash nuk e keni Shpend Ahmetin në parti, se po ta kishit, ndoshta, do ta ma njihnit punën rreth Ligjit për Prishtinën. Kur kam ardhur në Qeveri, kategoritë e lirisë kanë qenë lypsarë. Të gjithë i kanë pasur 50 euro. Janë goxha do punë që kjo Qeveri i ka kryer bukur mirë", ka thënë Haradinaj. Po ashtu, Haradinaj ia ka përmendur Kurtit edhe largimet nga Vetëvendosja.



Me porosinë "Zgjidh shëndetin, jo duhanin" është shënuar në Kosovë Dita Botërore pa Duhan

# Ministri Ismaili kërkon që Ligji për Duhanin të zbatohet në tërësi

**Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka kërkuar që Ligji për Kontrollin e Duhanit të zbatohet më shumë. Ai ka thënë se një numër i konsiderueshëm organesh mbikëqyrëse dhe të ekzekutimit për zbatimin e këtij ligji kanë treguar mangësi në rezultate në bazë të kompetencës së tyre të përcaktuar me ligj**




EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë të enjten se përdorimi i duhanit është problem global i shëndetit publik. Ai ka thënë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kosovë janë krijuar shumë mjedise 100 % pa duhan, por që të gjithë duhet të angazhohen më shumë që ligji të zbatohet në tërësi. "Dëshmitë e reja shkencore përditë e më tepër e alarmojnë botën se tymosja e duhanit po e rrezikon seriozisht shëndetin e përgjithshëm të popullatës. Në këtë kontekst, një prej qëllimeve kryesore të Ditës Botërore pa Duhan në Kosovë është ngritja e vetëdijes mbi prevalencën e pirjes së duhanit dhe efektit të saj te fëmijët/nxënësit", ka thënë ministri Ismaili me rastin e shënimit të Ditës Botërore pa duhan që u organizua nga Zyra e OBSh-së në Kosovë, MSh, IKShP e KADC me moton "Duhani thyen zemrat, zgjidh shëndetin, jo duhanin".

Ministri Ismaili ka theksuar se qëllimi është që të inkurajohet një mbështetje e fortë publike dhe politike kundër pirjes së duhanit, për të parandaluar shumë prej implikimeve serioze shëndetësore të cilat ndërlidhen me thithjen e tymit të duhanit, ndërkohë ka paralajmëruar një sërë masash të cilat përmes zbatimit të këtij ligji prioritet do ta kenë ruajtjen e shëndetit të fëmijëve që është prioritet i MSh-së. Ai ka thënë se një numër i konsiderueshëm organesh mbikëqyrëse dhe të ekzekutimit për zbatimin e këtij ligji (secili në sektorin e vet) kanë treguar mangësi në rezultate në bazë të kompetencës së tyre të përcaktuar me ligj.

Ismaili ka thënë se MSh-ja bashkë me institucionet e tjera përgjegjëse do t'i adresojë edhe sfidat e dala nga Raporti i Progresit për ta siguruar zbatimin e këtij ligji. Shefja e Zyrës së OBSh-së në Kosovë, Ardita Tahirukaj, ka thënë se, sipas raportit të ri të kësaj organizate, përdorimi i duhanit ka rënë ndjeshëm që nga viti 2000, por reduktimi është i pamjaftueshëm për t'i përmbushur objektivat e miratuara globalisht për mbrojtjen e njerëzve nga vdekja, vuajtjet nga sëmundjet kardiovsakulare dhe sëmundjet jongjitëse. "Qeveritë kanë fuqinë në duart e tyre për t'i mbrojtur qytetarët e tyre nga sëmundjet e zemrës dhe sëmundjet e panevojshme. Një shtet i shëndetshëm është një shtet i pasur", ka thënë ajo, duke theksuar se vetë shteti i Kosovës dhe popullsia e saj e re do të përfitonte nga zbatimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit i aprovuar në vitin 2013, i cili është në përputhje me Konventën Kornizë të OBSh-së. Drejtori i IKSHP-së, Naser Ramadani, ka thënë se prevalenca e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve (13-15 vjeç) krahasuar me hulumtimin e kaluar (GYTS I 2004) nga 6.7 % është ulur në 4.4 % (2016), ndërkohë që ekspozimi ndaj tymit të duhanit brenda ndonjë ambienti të mbyllur është ulur nga 84 % në 43 %, derisa prevalence e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve krahasuar me hulumtimin e kaluar është nga 10.4 % në 8.8 %.

Arben Lila nga KADC (Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim) ka thënë se pas pesë vjetësh që prej hyrjes në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, Qeveria qendrore, autoritetet komunale, shoqëria dhe qytetarët mund të bëjnë më shumë duke mbështetur zbatimin e ligjit në vendet publike pa duhan, vendet e punës, spitale, administratë, shkolla dhe t'i mbrojnë qytetarët nga efektet negative të duhanpirjes. Ai ka thënë se edhe sektori komercial duhet ta respektojë ligjin dhe të sigurojë ambiente 100 % pa tym duhani, ndërkohë që u shpreh se është evidente se zbatimi këtij ligji do të jetë një përkushtim afatgjatë, ndërsa Kosova është në kilometrin e pestë të kësaj maratone që synim ka mbrojtjen e shëndetit publik të qytetarëve.

# Avokati i Popullit publikon 23 raporte për zvarritjen e procedurave gjyqësore

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Avokati i Popullit më 29 maj ia ka përcjellë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë gjithsej 23 raporte me rekomandime, prej të cilave 17 gjykatës të Gjykatës së Apelit dhe gjashtë gjykatës të Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore në kontestet civile. Nga rastet që janë trajtuar në këto raporte, Avokati i Popullit ka gjetur se procedurat gjyqësore zgjasin deri 14 vjet, e që kjo kohëzgjatje ka gjasa të rritet më shumë, meqë të njëjtat vazhdojnë të jenë në shqyrtim nga gjykatat përkatëse. "Së këndejmi, Avokati i Popullit, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi si dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka konstatuar se ka shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, duke pasur parasysh se 'çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm'. Po ashtu, është konstatuar se ka shkelje të së drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, duke marrë parasysh se 'çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur'", është thënë në njoftimin e institucionit të Avokatit të Popullit.




Avokati i Popullit u ka rekomanduar gjykatave përkatëse që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrin të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen e rasteve, për të cilat është konstatuar se ka zvarritje të procedurave gjyqësore. Të 23 raportet me rekomandime, të datës 29 maj, që trajtojnë zvarritjen e procedurave gjyqësore në konteste civile, ashtu siç u janë përcjellë autoriteteve përgjegjëse, në formatin e tyre të plotë u janë përcjellë medieve. Po ashtu, raportet janë publikuar edhe në uebfaqen zyrtare të IAP-së.

# Kuvendi debaton të hënën për platformën e dialogut me Serbinë

**Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e së hënës do ta shqyrtojnë projekt-platformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Kjo platformë synim kryesor ka arritjen e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut. Por, deri më tani pozita dhe opozita nuk kanë arritur t'i përafrojnë qëndrimet lidhur me këtë çështje**




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 MAJ - Projekt-platforma shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve do të diskutohet të hënën në seancën e Kuvendit. Kështu është vendosur në mbledhjen e së enjtes të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Platforma synon arritjen e marrëveshjes ligjërisht të obligueshme për të dyja palët, që nënkupton njohjen e ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kjo platformë parasheh edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por që procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi.

Synim kryesor i kësaj platforme është arritja e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut me Serbinë. Megjithatë, deri më tani partitë politike në pushtet dhe ato në opozitë ende nuk kanë arritur t'i përafrojnë qëndrimet e tyre lidhur me këtë çështje. Madje, një nga partitë brenda koalicionit qeverisës, Nisma Socialdemokrate, nuk është e pajtimit që dialogu të udhëhiqet nga presidenti Thaçi.

Shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Bilall Sherifi, duke folur për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, ka thënë se Nisma insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Sipas tij, Qeveria nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka në këtë proces. "Nisma Socialdemokrate vazhdimisht ka insistuar dhe insiston që dialogu të mbetet brenda Qeverisë. Ne nuk jemi kundër idesë që dialogu të fillojë simbolikisht ndërmjet dy presidentëve dhe në fund të përfundojë me atë që quhet 'Handshaking'. Pra, t'ia japin dorën njëri-tjetrit dhe të nënshkruajnë. Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga përgjegjësia kushtetuese që ka, kurse në fund, pse jo, le t'i marrë meritat presidenti, nëse i ka mbetur aq shumë tek marrja e meritave në fazën e fundit të dialogut. Nuk mendoj se presidenti duhet të jetë ai që duhet të shkojë për t'i negociuar detajet e përditshme, të mërzitshme dhe të lodhshme që i ka një proces dialogues", ka thënë Sherifi për gazetën "Epoka e re".

Kurse nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka thënë se në fazën finale të dialogut me Serbinë secili institucion duhet të marrë pjesë në këtë proces. Ai ka theksuar se, përveç institucioneve shtetërore, një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces duhet ta ketë edhe opozita. "Kjo është një prej çështjeve madhore që e kemi diskutuar në tryezë bashkërisht. Siç po duket, kjo faza e fundit e dialogut final do të jetë një proces jo i lehtë për Kosovën. Ne si LDK edhe në këtë aspekt kemi qenë të hapur të diskutojmë në mënyrë që përgjegjësinë ta marrin edhe institucionet kushtetuese në bazë të përgjegjësive që kanë, por një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces ta luajë edhe opozita. Duke mos i ditur ende të gjitha detajet rreth këtij procesi, ne ende në kryesi nuk e kemi diskutuar dhe nuk kemi qëndrim definitiv sa i takon kësaj çështjeje", ka deklaruar Veliu për gazetën "Epoka e re". Ai ka bërë me dije se LDK-ja si parti institucionaliste nuk lidhet shumë me emra se kush do ta udhëheqë dialogun me Serbinë.

Veliu ka mohuar mundësinë që brenda LDK-së të ketë ndarje të mëdha rreth asaj nëse duhet që presidenti Hashim Thaçi ta udhëheqë këtë proces. "Duke pasur parasysh se LDK-ja është parti institucionaliste, ne nuk lidhemi shumë me emra dhe nuk bisedojmë shumë për emra. Ne mendojmë se secili institucion në Kosovë duhet ta luajë rolin e vet dhe duhet ta marrë përgjegjësinë që i takon në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës. Nuk ka asnjë përçarje brenda LDK-së për këtë çështje", është shprehur Veliu.

Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ali Lajçi, ka thënë për gazetën se presidenti nuk duhet ta udhëheqë dialogun me Serbinë. Sipas tij, Thaçi i ka sjellë vetëm të këqija vendit nga ky proces. "Ky dialog nuk prodhon rezultat. Ka qenë një driblim për t'i dhënë shans Serbisë që të përfitojë. Vazhdimi i dialogut mund të bëhet vetëm nëse Serbia e njeh pavarësinë e Kosovës dhe kemi një formulë juridike. Çdo dialog pa njohjen e pavarësisë shkon në dobi të Serbisë, prandaj fundi i këtij procesi do të duhej të ishte njohja e pavarësisë. Pa njohjen e pavarësisë çdo dialog është i kotë sepse Serbia çdo çështje e politizon. Presidenti ka sjellë vetëm trendë negativë në këtë proces. Për procesin e dialogut duhet të ketë një platformë të qartë konsensuale, e cila do të duhej të miratohej nga Kuvendi. Në këtë platformë do të duhej bërë e qartë se nuk ka vazhdim të dialogut me Serbinë pa njohjen e pavarësisë së Kosovës. Dialogu i deritashëm ka qenë i dëmshëm për Kosovën", ka theksuar Lajçi.

# Kongresi amerikan vlerëson punën e Kuvendit

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të enjten në takim një delegacion nga Kongresi Amerikan, i kryesuar nga Omri Rahmil, këshilltar politik i kongresmenit Peter Roskam (kryetar i Komisionit të Kongresit për Partneritet në Zhvillimin e Demokracisë - HDP), shoqëruar nga përfaqësues të USAID-it dhe NDI-së nga Uashingtoni.

Në takim u diskutua për partneritetin midis Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kongresit Amerikan dhe ndihmën e gjithanshme që agjencitë e ShBA-së i kanë dhënë dhe po i japin Kuvendit për ngritjen e kapaciteteve në shumë segmente.

Kryeparlamentari Veseli ka falënderuar miqtë amerikanë për këtë mbështetje, ndërsa ka garantuar vazhdimin e këtij partneriteti edhe në të ardhmen.

Zyrtarët nga Kongresi Amerikan falënderuan kryetarin Veseli për bashkëpunimin e ngushtë, ndërsa vlerësuan punën e mirë në fushën e transparencës para publikut dhe të llogaridhënies.



# Lansohet softueri për cilësinë e ajrit

Të enjten është lansuar softueri për të dhënat rreth cilësisë së ajrit, ku qytetarët tash e tutje do të informohen saktë dhe në kohë reale mbi cilësinë e ajrit. Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka paralajmëruar se MMPH-ja do ta zhvillojë edhe aplikacionin për telefona, në të cilin qytetarët do të kenë informacion të drejtpërdrejtë nga telefoni për indeksin e kualitetit të ajrit

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 31 maj** - Në kuadër të Javës së Mjedisit, ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka prezantuar të enjten lansimin e softuerit për të dhënat rreth cilësisë së ajrit. Me rastin e lansimit të këtij softueri ministrja Reshitaj u shpreh e kënaqur që tani qytetarët do të informohen saktë dhe në kohë reale mbi cilësinë e ajrit në disa komuna të Kosovës, kurse MMPH-ja në bazë të vlerave të ndotësve për periudha të caktuara do të marrë vendime dhe masa drejt zvogëlimit dhe kontrollit të ndotjes së ajrit. "Duke u bazuar në rëndësinë që ka informimi i qytetarëve për nivelin e ndotjes së ajrit dhe impaktin pozitiv në ndërgjegjësimin e tyre në mbrojtjen e ajrit nga ndotja si dhe me qëllim të ngritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies sot po lansojmë softuerin për cilësinë e ajrit në Kosovë", ka deklaruar ministrja Reshitaj.

Ajo ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen e dhënë për realizimin e këtij softueri, Qeverinë Amerikane e cila përmes MMC-së po ndihmon në shtrirjen me të madhe gjeografike të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe investime në mirëmbajtje të stacioneve si dhe JICA-në japoneze për kontributin e dhënë në ngritjen e kapaciteteve në stacionet për matjen e cilësisë së ajrit. Po ashtu, ministrja Reshitaj ka thënë se softueri që po lansohet sot është plotësisht i përshtatshëm me Indeksin e Kualitetit të Ajrit në Evropë dhe bën monitorimin e pesë ndotësve kryesorë i cili përbën edhe indeksin e kualitetit të ajrit.

Në fund ministrja Reshitaj ka theksuar se në hap drejt avancimit të sistemit të informimit të publikut, MMPH-ja do ta zhvillojë edhe aplikacionin për telefona, në të cilin qytetarët do të kenë informacion të drejtpërdrejtë nga telefoni për indeksin e kualitetit të ajrit.




# Oda Amerikane bën thirrje për dialog më të fuqishëm publiko-privat

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 31 maj** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me nivelin e zvogëluar të dialogut ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, duke e konsideruar atë hap mbrapa në partneritetin ndërmjet institucioneve legjislative dhe ekzekutive në njërën anë, si dhe përfaqësuesve të sektorit privat në anën tjetër, i cili rezultoi në një progres të jashtëzakonshëm në lehtësinë e të bërit biznes.

Oda Amerikane është e brengosur me faktin se disa nga vendimet e marra së fundmi, e të cilat ndikojnë në sektorin privat, janë marrë dhe po imponohen pa interaksion të mirëfilltë formal. "Oda Amerikane konsideron se mekanizmat si Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik janë të duhur për adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballet sektori privat në Kosovë, përfshirë sundimin e dobët të ligjit dhe korrupsionin, burokracinë, disponueshmërinë e fuqisë punëtore dhe shumë të tjera. Prandaj, Oda Amerikane kërkon nga institucionet e Kosovës të promovojnë dhe fuqizojnë dialogun me të gjitha asociacionet e biznesit përmes KKZhE dhe mekanizmave të tjerë formalë, si dhe të përmbahen nga veprimet dhe vendimet e njëanshme", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.




# Prokurorітë dhe gjykatat rrisin performancën në luftën kundër korrupsionit

"Prokuroritë dhe gjykatat kanë treguar performancë pozitive në trajtimin e lëndëve të reja të korrupsionit duke zgjidhur më shume lëndë sesa kanë pranuar gjatë viti 2017", kështu ka thënë Jeton Zulfaj, menaxher i programeve nga Lëvizja FOL në publikimin e raportit me titull "Performanca e gjyqësorit dhe prokurorisë në luftën kundër korrupsionit për vitin 2017"

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 MAJ - Lëvizja FOL ka mbajtur të enjten një tryezë, në të cilën është publikuar edhe raporti me titull "Performanca e gjyqësorit dhe prokurorisë në luftën kundër korrupsionit për vitin 2017".

Jeton Zulfaj, menaxher i programeve nga Lëvizja FOL, ka thënë se ky është edicioni i dytë i raportit "Përtej numrave". Ai ka thënë se sikurse vitin e kaluar, edhe për vitin 2017 Lëvizja FOL ka bërë matjen e performancës së prokurorive dhe gjykatave në luftën kundër korrupsionit. "Për çdo ditë hasim termin korrupsion dhe sivjet ka qenë shumë i pranishëm për faktin se ka mbetur kriteri i fundit për liberalizim të vizave. Në nivel qendror edhe prokuroritë edhe gjykatat kanë treguar performancë pozitive për trajtimin e lëndëve të reja të korrupsionit duke zgjidhur më shume lëndë sesa kanë pranuar gjatë viti 2017", ka thënë Zulfaj.

Sipas Zulfajt, raporti është statistikor dhe Lëvizja FOL është duke ofruar një pasqyrë për prokuroritë dhe për gjykatat që të shohin dhe të maten me vetveten, mirëpo raporti nuk mund të tregojë se si janë zgjidhur lëndët. Ndërsa kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Blerim Isufaj, ka thënë se trendi i zgjidhjes së lëndëve është pozitiv, me mbi 25 për qind. "Nuk ka asnjë dilemë se ne kemi avancuar, është rritur buxheti si dhe janë aprovuar 148 pozita shtesë vetëm për personel administrativ", ka thënë Isufaj.

Ndërsa kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Nehat Idrizi, ka thënë se ky këshill ka bërë përpjekje për luftimin e korrupsionit. "Si fillim kemi themeluar grupin punues dhe kemi hartuar planin e veprimit për lëndët e korrupsionit, që kanë të bëjnë me shënjestrimin, monitorimin dhe raportimin mbi statusin e lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë, i ashtuquajtur mekanizmi përcjellës si dhe kemi krijuar grupin punues për lëndët e korrupsionit në përbërje të gjyqtarëve. Të dy këta mekanizma i shërbejnë KGjK-së dhe ofrojnë rekomandime të politikave në luftën kundër korrupsionit", ka thënë Idrizi.

Raporti i FOL-it ka konstatuar se në nivel qendror, prokuroritë kanë pasur një performancë pozitive dhe kanë ngritur perfromancën nga 130 për qind në 135 për qind në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Sipas këtij raporti, njëjtë edhe gjykatat kanë një performancë pozitive edhe në vitin 2017 me zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, megjithatë gjykatat kanë një rënie të performancës kur krahasohen me vitin 2016 që ishte 122 për qind në 114 për qind për vitin 2017.

Më tutje, ky raport ka theksuar se keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar mbetet vepra më e përsëritur e korrupsionit, ku prej 826 personave nën hetime nga prokuroria, afër 90 për qind e tyre i përkasin kësaj vepre penale. Po ashtu, ky raport ka theksuar se nëse korrupsioni shikohet përmes numrave, atëherë në vitin 2017 ka një rënie prej më shumë se 200 personave nën hetime nga prokuroria për korrupsion.

Nga 826 persona ndaj të cilëve kishte kallëzim penal për korrupsion në vitin 2016, ky numër ka rënë në 622. Ky numër është prapë i lartë duke treguar se korrupsioni mbetet i pranishëm. Prokuroria Speciale ka pasur normën më të mirë të zgjidhjes së lëndëve për persona prej 323 për qind, e ndjekur nga ajo e Prishtinës më 141 për qind. Megjithatë, edhe Prokuroria Speciale edhe ajo e Prishtinës vazhdojnë të kenë një numër të madh të lëndëve të bartura.

# FMN-ja vlerëson bashkëpunimin me institucionet e Kosovës



PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Kosovën të udhëhequr nga Stephanie Eble.

Gjatë takimit ministri Hamza e ka njoftuar Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për progresin të cilin e ka arritur Kosova gjatë këtyre muajve në fushën e financave, për trendin e mirë të të hyrave, për nivelin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për stabilitetin makrofiskal në përgjithësi.

Po ashtu, ministri Hamza e ka njoftuar Misionin e FMN-së për ligjet e reformës tatimore dhe planet për t'i vazhduar reformat në politika fiskale në të mirë të të bërit biznes në Kosovë.

Ministri Hamza është shprehur se Ministria e Financave vazhdon të ketë raporte të shkëlqyera me Fondin Monetar Ndërkombëtar si dhe ka falënderuar këtë organizatë për ndihmën që është duke dhënë për ministrinë që drejton dhe agjencitë e saj. Ndërsa udhëheqësja e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Stephanie Eble, ka falënderuar ministrin Hamza për paraqitjen e progresit dhe ka vlerësuar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të misionit të FMN-së me Ministrinë e Financave.

# Shtrohet rruga "Dervish Qollaku" te zona industriale

**Prishtinë, 31 maj (ER)** - Rruga "Dervish Qollaku" te zona industriale është një prej rrugëve më të frekuentuara si qarkore e Prishtinës. Si rrjedhojë, kohët e fundit është dëmtuar dukshëm dhe në të janë hapur shumë gropa. "Intervenuam, duke i bërë të gjitha sanimet e nevojshme, si dhe duke e shtruar shtresën e re të asfaltit, ashtu që ta lehtësojmë qarkullimin e qytetarëve në këtë pjesë të qytetit", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.





# Sot fillon dezinsektimi në Prishtinë

**Prishtinë, 31 maj (ER)** - Sot (e premte) fillon faza e parë e dezinsektimit hapësinor për këtë vit në Komunën e Prishtinës. Sipas një njoftimi të komunës, kjo ditë është zgjedhur pas të gjitha përgatitjeve teknike dhe operative nga ana e Komunës së Prishtinës, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe kompanisë që do ta kryejë këtë proces. "Për herë të parë ky proces do të kryhet në gjashtë faza, duke përfshirë kështu gjithë sezonin gjatë të cilit janë aktive mushkonjat dhe insektet e tjera. Duke u bazuar në këto të dhëna, sivjet do të dezinsektohet një sipërfaqe mbi 6 500 hektarë, duke përfshirë edhe zona rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Edhe këtë vit do të përdoren preparatet e sigurta të regjistruara për përdorim në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dezinsektimi do të bëhet çdo ditë duke filluar nga ora 19:30 deri në orën 24:00.

# Në Mitrovicë janë në realizim 25 projekte kapitale

**Mitrovicë, 31 maj (ER)** - Në Komunën e Mitrovicës janë duke u realizuar 25 projekte kapitale, që arrijnë vlerën disa miliona euro, të siguruar nga buxheti komunal dhe ai qeveritar. Sipas një njoftimi të Komunës së Mitrovicës, para pak ditësh ka përfunduar projekti i asfaltimit të rrugëve në Stantërg. "Me intensitet janë duke u zhvilluar punët për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatrat Zasellë, Rahovë, Frashër, Suhadoll, Vidimriq, Bajgorë (nëper lagje) dhe hapja e rrugës Melenicë-Maxherë-Dedi-Batahir-Bistricë. Në përfundim e sipër janë edhe rrugët kryesore brenda në qytet", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Mitrovicës. Po në përfundim e sipër janë edhe punët për shtrimin me kubëza të disa rrugëve në Iliridë, Bair dhe Shipol. "Përveç projekteve për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve, në realizim e sipër janë edhe projektet të tjera kapitale dhe shumë të rëndësishme për qytetarë, siç janë: ndërtimi i kanalizimit fekal në Iliridë, afër Universitetit 'Isa Boletini', ndërtimi i kanalizimit atmosferik në disa lagje në qytet, debllokomi i kanalizimeve po në disa lagje të qytetit, ndërrimi i gypave të ujësjellësit prej betoni me gypa PVC në Iliridë e Shipol etj", thuhet në njoftimin e Komunës së Mitrovicës.



Kryetari i Komunës, Agim Bahtiri, ka inspektuar punët për realizimin e pothuajse të gjitha këtyre projekteve, për të parë nga afër se deri ku kanë shkuar ato. Kryetari Bahtiri me këtë rast ka bërë vërejtje serioze në punët e disa projekteve dhe ka kërkuar nga punëkryesit që ato të përmirësohen.



# Vizitohen familjet e minoriteteve në Banjë, Malishevë dhe Kijevë

Malishevë, 31 maj (ER) - Komiteti për Komunitete ka vizituar tri lokalitete ku jetojnë komunitetet minoritare, në Banjë, në Malishevë dhe në Kijevë, me qëllim që të njihen nga afër me gjendjen socialekonomike dhe me kërkesat e tyre. Disa ditë më parë Komuna e Malishevës kishte filluar realizimin e projektit për ndërtimin e shtëpive.

Përfituese e këtij projekti ishte familja e Rrahman Kovaçit, e cila jeton në fshatin Banjë, në kushte jo të mira të banimit. Shtëpia e cila tashmë u ndërtua është vizituar edhe nga anëtarët e Komitetit për Komunitete si trup i Kuvendit të Komunës së Malishevës, ku u ndanë të kënaqur me punët e deritanishme të kryera.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete vizitën e vazhduan edhe në Malishevë e Kijevë, për t'u njoftuar me gjendjen e banorëve të komuniteteve minoritare në lokalitetet ku jetojnë, në Malishevë e Kijevë.

# Në Açarevë do të rinovohet akademia e parë ushtarake e UÇK-së

**Prishtinë, 31 maj** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, dhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, të enjten kanë nënshkruar tri memorandume mirëkuptimi, dy në fushën e trashëgimisë kulturore dhe një në fushën e sportit. Në fushën e trashëgimisë kulturore sipas memorandumit do të bëhet restaurimi i akademisë së parë luftarake të UÇK-së në Açarevë dhe rikonstruktimi i kullës së Shaban Manxhollit në fshatin Mikushnicë. Kurse në fushën e sportit, MKRS-ja do të investojë fillimisht 200 mijë euro për ndërtimin e një stadiumi në fshatin Runik.



# Për Xhemën që na mungon



Mimoza KELMENDI

Sa herë vjen maji dhe kujtojmë ditëlindjen e heroit të betejës së Koshares, dëshmorin Xhemajl Fetahaj, shfletoj edhe librin e Ibish Nezirit "Këtu jam për t'i luftuar armiqtë" si për t'u çmall edhe më shumë me mikun tonë. Ndaj personalisht i shpreh mirënjohje Ibishit për këtë monografi, sepse përmes këtij libri e kemi Xhemën gjithmonë mes nesh, pasi jam e bindur se të gjithëve na mungon sot. Por edhe për të na bërë edhe më krenarë me Xhemën që e kishim shok, mik, bashkudhëtarë të rrugës për lirinë e Kosovës.

Sa herë rilexoj librin më duket sikur zbuloj edhe më shumë një Xhemë tjetër edhe më të madh, një personalitet me plot kuptimin e fjalës. Jo vetëm për aktin që ra heroikisht në betejën e Koshares bashkë me shokë të tjerë, por për gjithë jetën e tij që kishte punuar me përkushtim për këtë ditë që gëzojmë ne të gjithë si qytetarë të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Kam pasur fatin të bisedoja shumë herë me të, nëpër udhëtime apo tubime, kishim ngrënë bukë tek njëri-tjetri disa herë, por sinqerisht e paskam njohur pak dhe më vjen vërtet keq që nuk e paskam njohur në këto përmasa. Xhema ishte shumë modest dhe ai kurrë nuk fliste për veten.

Xhema ynë lindi dhe u rrit në fshatin Raushiq në jug të Pejës, ku qysh i ri filloi kontaktet me lëvizjen ilegale duke hedhur hapat e tij të parë në veprimtarinë e organizuar të asaj kohe. "Armët dhe librat ishin dy gjërat e dashura për mua, ishin ushqimi im shpirtëror që më mbante dhe më ushqente", shkruante Xhemajli.

Ai ishte 17 vjeç kur u zhvilluan demonstratat e '81-s. Pikërisht nën frymëzimin e këtyre ngjarjeve që tronditën botën, Xhemajli do të fillojë me të afërmit e familjes së tij të shkruajnë parullat e para "Kosova Republikë" dhe më pas, ditë pas dite e muaj pas muaji, bashkë me shokët do të bëheshin mjaft aktivë në këtë zonë të Pejës me një sërë veprimtarish që ranë në sy të ish-shërbimit sekret jugosllav, UDB-ës, ku si pasojë, në janar të 1984-s do të burgosej bashkë me shumë shokë të tjerë. 6 vjet burgim vendosi në atë kohë Gjykata e Qarkut të Pejës për heroin Fetahaj. Bashkë me të edhe anëtarë të tjerë të familjes Vehbi, Demë, Muharrem e Miftar Fetahaj. Dënimi i pesë djemve nga kjo familje ishte një goditje e madhe për prindërit dhe të afërmit, por nga ana tjetër pati edhe efektin e saj pozitiv në gjithë rrethinën e Pejës e më gjerë.

Shpirti prej luftëtari, Xhemajlin nuk e linte të qetë. Ai as në burg nuk heshti, por gjithmonë kundërshtonte autoritetet serbe. Pas daljes nga burgu në vitin 1988, përveç veprimtarive politike, ai do të ishte një pjesëmarrës aktiv edhe në aksionin e pajtimit të gjaqeve. Madje këtë aktivitet e nisi në fshatin e vet Raushiq ku dy familje ishin në hasmëri. Më pas në Kosovë situata u bë mjaft e rrezikshme, veçanërisht për njerëz si Xhemajli që e kishin në shënjestër për çdo hap që hidhte. Ndaj e vetmja rrugë ishte largimi i përkohshëm nga vendlindja dhe qëndrimi në Gjermani, ku prej janarit 1991 ai do të vendosej fillimisht në Dyseldorf, pastaj në Mönchengladbach. Pikërisht këtu Xhemajli do të mbajë shënime në ditarin e tij: "Njeriu me durim të madh mund të shpresojë se një ditë do ta arrijë atë që e dëshiron dhe mendon, por durimi dhe mjeshtëria e të duruarit janë një lloj arti i komplikuar, një teknikë që kërkon mund e sakrifica të mëdha".

Janë pikërisht këto fjalë të shkruara nga Xhema që tregojnë edhe një herë besimin e tij dhe shumë bashkudhëtarëve të rrugës së tij se një ditë Kosova do të ishte e lirë. Si çdo njeri edhe Xhemajli kishte dëshirën e tij për të krijuar familje, strehën e ngrohtë me gruan dhe fëmijët. Besa ishte dashuria e tij e madhe që i besoi gjithçka deri në ditën e fundit, i besoi fëmijët e tij (Arjanin e vogël dy vjeç dhe Erëzen ende të palindur) që nuk i gëzoi, por i bindur se ata do ta kenë pranë nënën e duhur. Ndaj nuk mungojnë edhe vargjet që i shkruan asaj në çaste të caktuar. Në ditar do të lexojmë një sërë shkrimesh, fragmente meditimesh apo qëndrimesh për situatën në Kosovë. Ai e vuante largimin nga Kosova që, sipas tij, e bënte të kishte trupin në Gjermani e mendjen në atdhe. Ja disa vargje:

Po
Shpirtin ma mban shpresa
se pushka kushtrimtare një ditë do të kërcasë
e të gjithë ata që zemra shqip iu rrahë
do të kthehen prapë në atdhe.

Në gjithë veprimtarinë e Xhemës një rol të madh ka luajtur Shqipëria. Ai si shumë bashkëkohësit e tij e shihnin Shqipërinë si një burim shprese e frymëzimi për të ardhmen e Kosovës. Ndaj të gjithë e donin edhe pa qenë kurrë atje, sepse shihnin vendin e vëllezërve dhe motrave të një gjaku, pavarësisht prej diktaturës që vuanin njerëzit. Ai dëgjonte rregullisht Radio Tiranën, emisionet në shqip dhe ngazëllehej: "Tani tingujt e Radio Tiranës janë duke me shoqëruar. Ah ky zëri i Shqipërisë gjithmonë ma ka ngrohur gjakun. Edhe tani më bën më të fortë, më jep forcë e nuk më lë të topitem", shkruante heroi ynë.

Ibish Neziri, autor i librit dhe mik e bashkudhëtar i rrugës së Xhemajl Fetahajt, e ka pasur fatin dhe privilegjin të punojë për këtë hero, sepse ai i kishte lënë pas shumëçka konkrete, pa qenë nevoja për t'i zmadhuar e zbukuruar të vërtetat e tij, e gjitha jeta e tij ishte një vepër e madhe, edhe pse dikush mund të jetë munduar ta kalojë nën hije atë.

Xhemajl Fetahaj u takon njerëzve të jashtëzakonshëm të Kosovës, sikurse Adem Jashari, Fehmi e Xhevë Lladrovci e shumë të tjerë, të cilët rrugëtimin e tyre patriotik e nisën qysh të rinj në bankat e shkollës duke braktisur gjithçka nga ëndrrat e tyre për të luftuar për një Kosovë ndryshe.

Xhemajli mbeti i thjeshtë deri në vdekje, i prerë ashtu si në bisedën me gazetarin gjerman, i saktë me pak fjalë, por i madh me veprën e vet.



# Haradinaj: Xhemajl Fetahaj, shembull i luftëtarit dhe patriotit shqiptar

Prishtinë, 31 maj (ER) - "Agim Ramadani, Sali Çekaj e Xhemajl Fetahaj janë tre emra që bëjnë historinë tonë në mënyrën e vet. Vijnë nga drejtime që i ka nxjerrë jeta dhe bashkohen në një qëllim, në një vend, në një betejë, në një epope që e bën historinë e kombit të tyre. Bashkohen në Koshare dhe aty që të tre flijohen për lirinë e atdheut të vet. Kemi shumë njerëz që janë flijuar për atdhe, por 'Epopeja e Koshares' dhe këta tre burra i japin një pamje të atdheut të tyre në mënyrën e vet, që të tre secili veç e veç", kështu ka thënë të enjten kryeministri Ramush Haradinaj, në akademinë përkujtimore në ditën e rënies së heroit Xhemajl Fetahaj.




Duke folur për luftën e lavdishme të Xhemajl Fetahajt dhe të komandantëve të tjerë, Haradinaj ka theksuar se të gjithë dëshmorët e Koshares, bijë dhe bija të këtij vendi, por edhe të popujve të tjerë, ua rritën namin dhe dimensionin e flijimit komandantëve të tyre. "Kam pasur rastin të jem një kohë bashkëluftëtar me Xhemajl Fetahajn. I kam njohur familjarët e tij, njerëzit rreth tij, dhe nuk kam asnjë dilemë se ai nuk ka qenë i denjë të jetë në krahë me Agimin e Salihun. Ai i ka përmbushur parametrat e një luftëtari shqiptar, një komandanti të luftës sonë, një patrioti që në momentet vendimtare është aty ku duhet", është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se duke respektuar shembullin e të rënëve, rruga e atdheut tonë, e ardhmja e popullit tonë do të jetë e ndritur. "Ne kemi vetëm një të ardhme, që të jetojmë të lirë, një të ardhme që të jetojmë në demokraci. Dhe ne i takojmë vetëm një familje, asaj perëndimore, euroatlantike, pra anëtar i BE-së dhe i NATO-s dhe kemi vetëm një perspektivë në botë, t'u qëndrojmë besnikë atyre që ishin besnikë me ne në kohët më të vështira të rrezikut tonë, Amerikës", është shprehur Haradinaj, duke theksuar se këto fjalë e kanë vendin pikërisht këtu sot kur përkujtohen njerëzit më të zotë të atdheut tonë që kanë rënë për liri.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se duke u shërbyer me shembullin e flijimit ne mund ta garantojmë të drejtën tonë që të jetojmë të lirë në demokraci, të bëhemi pjesë e familjes së popujve të lirë euroatlantikë dhe ta forcojmë miqësinë me Amerikën. "Unë e kam për nder që si një prej bashkëluftëtarëve mund ta nderoj këtë rrugë dhe ju ftoj të gjithëve të mos i ndahemi kësaj rruge", ka theksuar Haradinaj.

Në këtë akademi në emër të Brigadës 138 "Agim Ramadani" ka folur Xhafer Gashi, ndërsa në emër të familjes të pranishmit i ka përshëndetur Erëza Fetahaj, bija e heroit Xhemajl Fetahaj. Me këtë akademi përkujtimore ku u përkujtuan dëshmorët Xhemajl Fetahaj dhe Milazim Shala, përmbyllet manifestimi tradicional "Ditët e Shqipes 2018" kushtuar Betejës së Koshares, manifestime këto që janë mbajtur nën përkujdesjen e kryeministrit Ramush Haradinaj.

## Mocion votëbesimi për qeverinë spanjolle



MADRID, 31 MAJ - Parlamenti spanjoll filloi të enjten debatin mbi një votë mosbesimi kundër kryeministrit Mariano Rajoy. Votimi që do të zhvillohet sot (e premte) mund ta sjellë rrëzimin e Qeverisë së qendrës së djathtë të Spanjës pas gjashtë vjetësh në pushtet. Mocioni është sjellë nga kreu socialist i opozitës, Pedro Sánchez, pas përfundimit javën e kaluar të një gjyqi të gjatë korrupsioni, i njohur si rasti "Gurtel". Një gjykatë spanjolle gjeti fajtorë ish-zyrtarë të Partisë Popullore të Rajoy për kryerjen e një operacioni me mashtrim fondesh. E ardhmja e kryeministrit spanjoll Mariano Rajoy mbetet e paqartë, me kreun socialist Pedro Sanchez shumë pranë suksesit për ta detyruar atë të largohet nga posti.
Kreu socialist Sanchez, i sugjeroi Rajoy ta japë dorëheqjen për ta shmangur poshtërimin duke u bërë kryeministri i parë spanjoll që humbet votëbesimin.
"Do t'ju bëj një pyetje Rajoy, a jeni gati të jepni dorëheqje, a jeni gati të jepni dorëheqje sot, këtu, tani? Jepni dorëheqje Rajoy dhe gjithçka do të përfundojë. Ju mund të largoheni vetë nga Qeveria. A do ta japësh dorëheqjen apo do të vazhdosh të kapesh pas pozitës, duke dobësuar demokracinë, duke dobësuar dhe nënçmuar cilësinë e institucionit qeveritar?", tha Sanchezi.
Kreut socialist do t'i duhet një shumicë absolute prej 176 votash të premten për t'u bërë kreu i një Qeverie të re. Informacionet sugjerojnë se ai ka siguruar deri tani 175 vota. Sanchezi tha se nëse fiton votimin, ai do ta respektojë buxhetin e miratuar nga qeveria aktuale e Rajoyt dhe, gjithashtu, do të kërkojë të fillojë një dialog të ri me rajonin e trazuar të Katalonjës.

# Sekretari Pompeo bisedon me zyrtarin e Phenianit për takimin Trump - Kim

**Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, është takuar me Kim Yong Chol, dorën e djathtë të udhëheqësit të Koresë së Veriut, Kim Jong Unit, para bisedimeve të së enjtes për takimin e mundshëm ndërmjet Kim Jong Unit dhe presidentit amerikan, Donald Trump, muajin e ardhshëm**



UASHINGTON, 31 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se pati një "darkë shumë të mirë pune" me Kim Yong Cholin, dorën e djathtë të udhëheqësit të Koresë së Veriut, Kim Jong Unit, para bisedimeve të së enjtes për takimin e mundshëm ndërmjet Kim Jong Unit dhe presidentit amerikan, Donald Trump, muajin e ardhshëm.
Sekretari Pompeo postoi në rrjetin "Twitter" një fotografi ku shihet duke shtrënguar duart me Kim Yong Chol dhe një tjetër ku ata shihen të ulur në një apartament afër selisë së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.
Kim Yong Chol është zyrtari më i lartë i Koresë së veriut që viziton Shtetet e Bashkuara në 18 vjet. As ai e as sekretari Pompeo nuk folën me gazetarët. Shtëpia e Bardhë tha se ata kanë një ditë të plotë bisedimesh të enjten. "Ne jemi të përkushtuar për çarmatimin e plotë, të verifikueshëm dhe të pakthyeshëm bërthamor të gadishullit korean", shkroi sekretari Pompeo.
Por, Shtëpia e Bardhë tha se diskutimet për çarmatimin e plotë bërthamor nuk përfshinë sistemin e armatimit amerikan - një ombrellë mbrojtëse që mbulon Korenë e Jugut, e cila përfshinë nëndetëse bërthamore dhe bombardues strategjikë që mund të bartin bomba bërthamore, por nuk janë të vendosur në gadishull.
Koreja e Veriut vlerësohet se ka më shumë se duzinë armësh bërthamore.
Kim Yong Chol është nënkryetar i Komitetit Qendror dhe ish-shef i zbulimit të Koresë së Veriut. Ai dhe sekretari Pompeo janë takuar tashmë dy herë në Phenian.
Vizita e tij në Nju Jork ndodh ndërsa një delegacion amerikan mban bisedime me zyrtarë të Koresë së Veriut në zonën e çmilitarizuar dhe ekipet në Singapor ku mendohet të mbahet takimi, po përmbyllin hollësitë e tij.
Presidenti Donald Trump, që anuloi takimin historik javën e kaluar, tani ka në plan ta mbajë atë, duke shkruar në "Twitter" "përgjigje pozitive ndaj letrës sime, faleminderit!"
Ekspertët thonë se vendimi i udhëheqësit të Koresë së Veriut për ta dërguar krahun e tij të djathtë në Shtetet e Bashkuara është një fillim premtues.

# Lavrovi takohet me udhëheqësin e Koresë së Veriut



MOSKË, 31 MAJ - Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, u takua të enjten me ministrin rus të Punëve të Jashtme, i cili qëndroi në Phenian në një vizitë në të cilën Moska shpreson ta ritheksojë rolin e saj si një forcë që do të llogaritet përpara takimit të pritur të Kimit me presidentin amerikan, Donald Trump, në Singapor, muajin e ardhshëm.
Moska ka mbetur anash derisa Kim shtriu një komunikim të fuqishëm diplomatik me Seulin, Pekinin dhe Uashingtonin gjatë disa muajve të kaluar. Por vizita e Sergey Lavrovit lë të kuptohet se Rusia dëshiron të sigurohet se është e informuar për synimet e Koresë së Veriut dhe se ajo është e ndërgjegjshme për shqetësimet e Moskës.
Lavrovi i përcolli përshëndetjet dhe urimet më të përzemërta të presidentit Vladimir Putin për përpjekjet e mëdha të Kimit në Gadishullin Korean. Ai shprehu mbështetjen e Moskës për një marrëveshje që Kimi arriti me presidentin e Koresë së Jugut, Mun-Jaein, në një takim muajin e kaluar, që u përqendrua në masat për t'i ulur armiqësitë dhe për t'i rritur shkëmbimet mes dy Koreve.
Në një video nga fillimi i takimit shihet ministri Lavrov duke e ftuar Kim Jong Unin për një vizitë në Moskë dhe duke e përgëzuar atë për shumë projekte në kryeqytetin e tij. Sipas medies ruse, ai diskutoi rrugët e thellimit të marrëdhënieve gjatë një takimi me ministrin e Jashtëm, Ri Yong Ho. "Mirëpresim kontaktet që janë vendosur muajt e fundit ndërmjet Veriut e Jugut dhe ndërmjet Koresë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara", tha ministri Lavrov.

## Assad: ShBA-ja duhet të largohet nga Siria



DAMASK, 31 MAJ - Presidenti i Sirisë, Bashar al-Assad, tha se do ta rikthejë kontrollin e zonave që mbahen nga Forca Demokratike Siriane, milici kurde që mbështetet nga ShBA-ja dhe se forcat amerikane duhet të kenë mësuar nga Iraku dhe të largohen nga Siria.
Assad, po ashtu, tha se Qeveria "ka nisur t'i hapë dyert për negociata" me kurdët, që kontrollojnë zona në veri dhe lindje të Sirisë, ku janë të stacionuara edhe forcat amerikane. "Dialogu është opsioni i parë. Nëse jo, ne do t'i çlirojmë ato zona me forcë. Amerikanët duhet të largohen", tha Assadi. Duke iu përgjigjur përshkrimit që i ka bërë presidenti amerikan, Donald Trump, kur e ka quajtur "kafsha Assad", presidenti sirian tha: "Çfarë thua, ashtu je".

# Instituti Italian i Kulturës shtrihet edhe në Prishtinë

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në një takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, me të cilin ka diskutuar për shtrirjen e Institutit Italian të Kulturës edhe në Kosovë dhe për organizimin e një koncerti që do të mbahet më 4 qershor për nder të kompozitorit Gioachino Rossini, në 150-vjetorin e vdekjes së tij.

Ministri fillimisht e ka njoftuar ambasadorin italian për paraqitjen e Kosovës në Bienalen e Venedikut, duke e informuar për numrin e madh të vizitorëve që kishte Pavijoni i Kosovës dhe me këtë rast e ka falënderuar ambasadorin Sardi edhe për ndihmën e ofruar nga Ambasada e Italisë.

Ministri Gashi ka thënë se bashkëpunimi mes MKRS-së dhe Ambasadës së Italisë është shumë i mirë dhe për t'u vlerësuar. "Të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet e përbashkëta që kemi realizuar kanë treguar për një vullnet dhe frymë bashkëpunimi dhe gjithmonë në interes të kulturës", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq ambasadori Sardi i ka shprehur falënderime për mirënjohjen e treguar dhe ka thënë se e mbështesim Kosovën për të qenë e pranishme në ngjarjet e rëndësishme ndërkombëtare dhe pjesëmarrja e Kosovës në Bienale tregon se bashkërisht jemi në rrugë të mbarë.



Sardi e ka njoftuar ministrin Gashi se pas takimit të mëhershëm kur është diskutuar për shtrirjen e Institutit të Kulturës Italiane edhe në Kosovë, si ambasadë e kanë parashtruar kërkesën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë dhe ajo është miratuar. Ambasada e ka njoftuar edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.

Ambasadori ka kërkuar nga ministri të formalizohet kjo nismë dhe shtrirja e Institutit të Kulturës Italiane që ndodhet në Tiranë të bëhet realitet edhe në Kosovë, gjë e cila do të mundësonte që ngjarjet kulturore që mbahen në Tiranë, të shtrihen edhe në Prishtinë.

Ministri Gashi ka thënë se plotësisht është i gatshëm për t'i filluar procedurat për zyrtarizimin e këtij institucioni të rëndësishëm kulturor edhe në Kosovë. "Personalisht si ministër dhe stafi i MKRS-së do të angazhohemi maksimalisht për ta jetësuar sa më shpejt idenë e shtrirjes së këtij institucioni edhe në Prishtinë dhe për këtë do të nënshkruajmë edhe një memorandum bashkëpunimi", është shprehur Gashi.

Ministri e ambasadori diskutuan edhe për koncertin që do të organizohet për nder të kompozitorit Rossini, me ç'rast ministri Gashi me kënaqësi do të marrë pjesë në këtë ngjarje.

# Ekspozitë kolektive e studentëve në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë

GJAKOVË, 31 MAJ (ER) - Në ambientin e Fakultetit të Edukimit në Gjakovë është hapur për herë të parë ekspozita kolektive e studentëve nga programi parashkollor, e kuruar nga artisti Ilir Muharremi. Ekspozita u organizua në kuadër të lëndëve: "Metodologji e arteve figurative dhe punëdore me modelim".

Muharremi para se ta niste fjalimin ka cituar një thënie nga artisti kubist Pablo Picasso: "Çdo fëmijë është artist. Problemi është si të mbesim të tillë pasi të rritemi". Sipas tij, të rriturit janë më pak artist se fëmijët dhe këto edukatore të ardhshme pikërisht prekin këtë problem, artin në raport me fëmijët.




Në këtë ekspozitë u prezantuan piktura, video-art dhe instilacione. "E mira është se studentët, përveçse mësojnë për pikturën, ngjyrën, stilin, mësojnë edhe artin konceptual, që aplikohet tashmë në krejt botën dhe fëmijët shumë lehtë fitojnë njohuri edhe për këtë. Pastaj aplikohet edhe metodologjia. Pikturat janë të ndryshme duke filluar nga realizmi klasik, kalohet te poentilizmi, ekspresionizmi-abstrakt, surrealizmi, modernizmi...", ka thënë Ilir Muharremi në hapje të ekspozitës.

Ai ka bërë me dije se studentët kanë fituar njohuri për shumë elemente figurative, duke filluar nga më të thjeshtat: vija, forma e deri te përfitimi i ngjyrave. "Gjë të cilën tashmë janë të aftë ta aplikojnë në çdo institucion", ka thënë Muharremi.

Studentët në prani të profesorit Muharremi bën edhe aranzhimin e pikturave, element ky që kërkon profesionalizëm. "Nëse pikturat aranzhohen keq, atëherë edhe mund të duken keq", ka pohuar Muharremi.

Shaban Buza, rektor i Universitetit të Gjakovës, ka folur fjalë miradije për punën krijuese të studentëve. "Është bërë një punë e madhe dhe serioze nga studentët", u shpreh ai.

# MKRS-ja nënshkruan kontrata me 119 organizata të shoqërisë civile

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka nënshkruar kontrata me 119 organizata të shoqërisë civile, organizata rinore, përfituese në sektorin e rinisë, nga shpalljet e fundit publike në tematikat: kulturë, sport, rekreacion; siguri njerëzore; edukim shëndetësor; fuqizim dhe pjesëmarrje të të rinjve, parandalim të ekstremizmit.

Në ceremoni mori pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili u shpreh i gëzuar që po nënshkruhen kontratat në mes të MKRS-së dhe organizatave për projektet që ministria përkrah përmes thirrjeve publike. "Ne do ta ndjekim një praktikë të re e cila ka për qëllim që të gjitha projektet të cilat përfitojnë organizatat rinore, por edhe të rinjtë në përgjithësi në Republikën e Kosovës, t'i prezantojmë në mënyrë ceremoniale edhe për të qenë transparentë para publikut, por edhe për ta arsyetuar çdo cent MKRS-ja i ndan për organizatat rinore", ka thënë ministri Gashi.

Ministri ka porositur të rinjtë përfitues që projektet të cilat i kanë fituar t'i zbatojnë sipas kritereve të parapara dhe kërkoi nga ta që gjatë implementimit të projekteve të arrihet ndikim konkret.

Ministri Gashi ka theksuar se janë duke punuar përbrenda MKRS-së që ta ristrukturojnë Departamentin e Rinisë në mënyrën se si të bëhet shpërndarja e përkrahjes për të rinjtë. "Kosova duhet ta fokusojë një program të ri që do t'i ndihmojë të rinjtë rreth përgatitjes së tyre për tregun e punës, për ta përcaktuar profilin e secilit të ri në të ardhmen përmes këtyre projekteve rinore", u shpreh ministri, duke i njoftuar të rinjtë që MKRS-ja për herë të parë do të krijojë edhe një fond për të rinjtë në përkrahje të tyre si dhe për ndërtimin e kompleksit multifunksional rinor, i



pari i tillë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajonin e Ballkanit.

Ministri Gashi i ka informuar të rinjtë se në kuadër të kësaj përkrahje, MKRS-ja ndan mjete financiare dhe mbështet projekte edhe për të rinjtë e komuniteteve pakicë. Ministri në fund i porositi të rinjtë që ta rrisin bashkëpunimin dhe t'i zgjerojnë organizatat e tyre dhe rrjetet rinore. "Rinia është pjesa më vitale e shoqërisë sonë", ka vlerësuar ministri Gashi.

# Historia e dhëmbëve të Hitlerit dhe dyshimet mbi vdekjen në 1945

Ekzaminimi i dhëmbëve të Hitlerit ka rrëzuar çdo dyshim që ai vdiq me të vërtetë më 1945. Historia e dhëmbëve të Hitlerit është jo vetëm një histori e vdekjes së kryenazistit, por edhe e propagandës së Luftës së Ftohtë

Adolf Hitleri kishte dhëmbë jashtëzakonisht të këqij. Ajo që tingëllon si njëra prej mijëra vogëlsive, që ushqejnë magjepsjen e publikut për udhëheqësin nazist, është në fakt një dëshmi në njohuritë tona historike se Hitleri e vrau vërtet veten në 30 prill 1945.Një ekipi patologësh francezë ju lejua të inspektojë pak kohë më parë dhëmbë të ruajtur në Moskë, të cilat u morën në fillim të majit 1945 nga Berlini. Kjo është hera e parë në 70 vjet që autoritetet ruse lejuan dikë që të ekzaminojë ato që kanë mbetur nga Hitleri. Dhe konkluzionet e shkencëtarëve, të cilat u publikuan në fund të javës së shkuar në European Journal of Internal Medicine, janë të qarta.

“Dhëmbët janë autentike, nuk ka asnjë dyshim”, i tha kryepatologu Philippe Charlier agjencisë së lajmeve AFP. “Studimi ynë dëshmon që Hitleri vdiq më 1945”.

Ekipit të shkencëtarëve iu lejua të ekzaminojë edhe pjesë të kafkës së Hitlerit, për të konfirmuar se me ç’mjete e kreu vetëvrasjen ai. Dhëmbët përputhen me përshkrimet e dentistit të Hitlerit dhe nuk tregojnë asnjë gjurmë mishi – në përputhje me faktin se Fyhreri ishte vegjeterian.

Përfundimet e reja duhet t’u japin fund, por ndoshta kjo nuk do të ndodhë, përfytyrimeve të çmendura se drejtuesi nazist në njëfarë mënyre shpëtoi në shkatërrimet e Luftës së Dytë Botërore.

“Ne mund t’u japim fund të gjitha teorive të komplotit për Hitlerin”, tha Charlier. “Ai nuk është arratisur me një nëndetëse në Argjentinë; ai nuk ndodhet në një bazë të fshehur në Antarktidë ose në anën e errët të Hënës”.

Në vend të kësaj, historia e Hitlerit mori fund në atë mënyrë, si e beson çdo historian serioz: me një vetëvrasje të përbashkët në bunkerin e Fyhrerit në gërmadha e kryeqytetit nazist.



## Identifikimi i trupit të Hitlerit

Deri në 30 prill 1945, trupat sovjetike patën avancuar deri në 500 metra në afërsi të komandës së nëndheshme të Hitlerit në zemrën e Berlinit. I rrethuar dhe pothuaj në pamundësi për të komunikuar me ato pjesë të ushtrisë gjermane, Vehrmahtit që kishin mbetur, Hitleri e kuptoi se ëndrrat e tij për Perandorinë mijëvjeçare ose të Rajhut, patën marrë fund.

Pasdite herët, Hitleri u tërhoq me të dashurën e tij prej shumë vjetësh dhe bashkëshorten që prej më pak se dy ditësh, Eva Braun, në apartementin e tij personal. Atje ata pinë nga kapsula cianidi dhe e vranë veten me armë. Trupat e tyre – së bashku me ato të dy qenve të tij – u zbuluan në orën 15.15.

I ndërgjegjshëm se italianët e patën çnderuar kufomën e Benito Mussolinit, Hitleri pati lënë udhëzime, se si do të veprohej me kufomën e tij dhe të Eva Braunit. Ato i nxorrën nga bunkeri dhe i dogjën.

Vetëm në 5 maj zbuluan forcat e armatosura sovjetike një trup të djegur në një krater bombe dhe e identifikuan atë si trupin e Hitlerit.

“Dhëmbët e Hitlerit qenë të këqia – dhe në atë mënyrë të këqia – sa vetëm dhëmbët e tij e mundësuan që të identifikohet kufoma e tij”, shkroi në një artikull të botur në internet patologu forensik Mark Benecke, të cilin Televizioni National Geographic e ngarkoi që të ekzaminojë ato që kanë mbetur nga Hitleri. Ai shton se kariesi dhe sëmundjet e mishit të dhëmbëve ndoshta kanë qenë shkaku për frymën me erë tmerrësisht të keqe të Hitlerit.



Sovjetikët i krahasuan dhëmbët e viktimës, që kishin proteza që binin në sy dhe të pazakonta dhe ura, me përshkrimet e ndihmës-dentistes Käthe Heusermann. Më vonë, dentisti personal i Hitlerit, Hugo Blaschke, do të konfirmonte informacionet e aleatëve.

“Dhëmbët e tij qenë kaq të këqia, sa dentisti i tij rrinte me të në bunker”, i thotë Liubov Summ, mbesa e përkthyeses ruse të Heusermannit, Elena Rshevskaja, gazetës Times of Israel. “Ekzistojnë fotografi që janë shumë të pakëndshme për t’i parë”.

## Dinakëria e Stalinit – në themel të teorive të komplotit për Hitlerin

Rshevskajan e ngarkuan me dhëmbët e Hitlerit, sepse ekzistonte frika që ushtarët meshkuj të Ushtrisë së Kuqe do të deheshin dhe do t’i hiqnin nga ai vend dhëmbët. Ajo i solli ato që kishin mbetur nga Hitleri në Moskë. Por megjithëse sovjetikët e dinin me siguri që Hitleri kishte vdekur, Stalini urdhëroi që lajmi të mos përhapet. Në vend të kësaj duhet të përhapej lajmi, se aleatët perëndimorë e patën ndihmuar Hitlerin të arratisej fshehtas.

“Ishte një farsë mashtruese, një përpjekje e çuditshme, për ta fshehur faktin se u gjet kufoma e tij”, shkroi Rshevskaja në kujtimet e saj, të cilat u botuan më 1965 në gjuhën ruse, por të cilat u botuan vetëm në mars të këtij viti në gjuhën angleze. “Hitleri nuk qe më vetëm një simbol i luftës, ai u bë një simbol për një pjesë që duhet të vazhdonte.”

Fushatën e dezinformimit rusët e quajtën “Operacioni Mit”. “Strategjia e Stalinit me sa duket konsisonte shumë qartë në lidhjen e Perëndimit me nazizmin, duke përhapur që britanikët ose amerikanët duhet ta fshihnin atë”, shkroi historiani Anthony Beevor në librin e tij “Berlin-Rënia: 1945”.

Në kombinim me faktin se nazistë të shquar si Adolf Eichmanni dhe Josef Mengele u arratisën me të vërtetë në Argjentinë, dinakëria e Stalinit është në themel të lindjes së teorive të komploteve, se Hitleri në njëfarë mënyre kishte mbetur gjallë në Luftën e Dytë Botërore.

*(gazeta-Shqip.com)*



E rrallë

## NASA dërgon helikopter në Mars




NASA po dërgon një helikopter në planetin e kuq, duke iu bashkuar robotit të këtij planeti që pritet të hyjë në punë në vitin 2020. Nga agjencia amerikane e hapësirës thonë se "ideja e një helikopteri që fluturon qiellin e një planeti tjetër është tronditëse". Për të, shkencëtarëve u janë dashur katër vjet për ta bërë gati, ndërsa peshon vetëm 1.8 kg dhe kthetrat e tij sillen 10 herë më shpejt se një helikopter standard në Tokë.

FOTO E DITES




Burrat flenë nën hijen e një kamioni në shtetin perëndimor të Rajasthanit në Indi. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Policia e Indisë nxjerr 106 kapsula nga barku i një gruaje



Policia indiane ka bërë me dije se kanë nxjerrë 106 kapsula të kokainës nga barku i një gruaje, e cila ka dashur t'i kontrabandonte ato. 25-vjeçarja e cila u arrestua në aeroportin nacional në Delhi, ka kaluar disa javë në spital për t'u mjekuar nga efekti i kokainës.

## BARSOLETA E DITËS



**Gruas së re ia tërheq vërejtjen një mikeshë:**
**- Unazën e fejesës po e mbani në gisht të gabuar.**
**- E di, po jam fejuar me njeriun e gabuar.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo







**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot duhet të qëndroni larg dhe të ftohtë në lidhje me situatat që do t'ju paraqiten. Kështu do të jeni me objektiv në vendime.



**DEMI**
Keni shkuar përtej pritshmërive tuaja fillestare dhe keni bërë diçka për të cilën duhet të krenoheni vërtet. Është koha t'i dedikoheni më tepër familjes.



**BINJAKËT**
Mundësitë tuaja nuk janë shuar vetëm se nuk e keni pasur interesin e duhur për t'iu përkushtuar realisht. Çdo gjë do t'ju duket më e qartë me kalimin e kohës.



**GAFORRJA**
Sot do të bëheni ndërmjetës midis dy kundërshtarëve të betuar që të ulen dhe të bisedojnë me qetësi. Do të merrni kënaqësi personale.



**LUANI**
Nuk keni qenë shumë bindës në atë që keni kërkuar sot. Kjo gjë ka shkaktuar pak mosbesim tek ata persona që ju kanë mbështetur.



**VIRGJËRESHA**
Sot do të përballeni me gabimet që keni bërë në të shkuarën. Nëse i shihni me sy kritik, mbase mund të rikuperoni sa jeni në kohë.



**PESHORJA**
Mbase është më mirë t'u jepni mundësi të reja personave që keni parë vetë që dinë të përballojnë punën sesa atyre emrave anonimë që ju sugjerohen sot.



**AKREPI**
Po merrni vendime pa marrë në konsideratë pjesën më të rëndësishme të gjërave që ndodhin rreth e qark jush. Do të penalizoheni ju në fund të ditës.



**SHIGJETARI**
Tregohuni pak më diplomatë sot në sjellje nëse keni një synim për të arritur. Pasi të mbaroni punë mund ta thoni mendimin tuaj real.



**BRICJAPI**
Në një bisedë të rastësishme do të kuptoni që dikush ju ka tradhtuar. Edhe pse do të lëndoheni shumë do të arrini ta menaxhoni situatën.



**UJORI**
Nëse sot ju nevojitet kohë për të pushuar dhe për t'u qetësuar, mos u mendoni dy herë, por largojuni rutinës dhe stresit të së përditshmes.



**PESHQIT**
Të viheni në sfidë nga ana sentimentale mund të duket qesharake për ju që jeni në moshë të pjekur tashmë. Gjeni arsyen reale të problemeve.

AUTOR: GAZMEND MORINA

AKTORI HOLLIVUDIAN NË FOTO 1 | FILM I REGJISORIT JAMES CAMERON | SHPREHU ME FJALË | PJESË E SYRIT | NEON | ZANORE | DETYRË E AKTORIT | AKTORJA JONË CAHANI | EPOKA E RE | ATEMATIK, JO TEMOR (bised.) | AKTORJA E NJOHUR ITALIANE BELLUÇI | TË BUKURIT

1



FABRIKË KU BËHET PASTRIMI I NAFTËS
MA JEP HIT NGA "NRG BAND"
AVULL QË DEL NGA TOKA
GOJËTAR / DRAMË E FRANÇESK ANTON SANTORIT
GJENERALI YNË .... VESELI
SECILA NGA PJESËT QË FORMOJNË NJË TË TËRË (pashq.) / QESËNDI
ELIZABETH TAYLOR
"DIMONA" / FLOTA DETARE
FAMA, ZULMA / SHEJTAN, SATAN
MINERAL QË PËRDORET PËR PLLAKA IZOLIMI
TENEQE E TRASHË (shq.) / KRYEQYTETI I GANËS
NJËSI E VJETËR PESHE / AKTORI ... HANKS
SAHATI / FUTBOLLISTI GJERMAN MESUT .... (Real Madrid)
NDËRRIM I MALLIT / PJESË E DHOMËS
RAVENA
FUTBOLLISTI KRISTIANO / FLUTURAKJA E SHPEJTË USHTARAKE
ARKËTAR
ZANORE / KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE
EPOKA E RE
KYÇ
AJKA E SHOQËRISË
KËNGËTARJA SKOCEZE ... LENOKS
LAKESAT
USHQIMI KRYESOR I KINEZËVE
KËNGËTARJA SHQIPTARE BABALIU / AGRON TUFA
THIRRJE QË I BËHET MASËS / KLUB FUTBOLLI SUEDEZ
KALI I SHALËS / AMPER, INDIUM
KËNGË DJEPI / LLOJ PAPAGALLI
KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)
FORTESAT / QËLLIM I PARAMENDU-AR (sh.pashq.)
FUQIA, FORCA / BASHKËTING.
HENRIK (perkdh.) / PUNËTORI I TEATRIT TË KUKULLAVE
"KENIA" / ZIFTI
KËNGËTARI I FAMSHËM .... MARTIN
INDONEZIA / PERËNDESHË E DASHURISË (mit. romake)
NJËSI PËR MATJEN E KAPACITETIT ELEKTRIK / DY ZANOR
DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE / RYSHFET
ISLANDA / ISMET PEJA
HUMORISTI THAQI / FLETA ME TË CILËN E FTOJMË DIKË
NJËRI NGA VËLLEZËRIT FRASHËRI / BASHKË; TOK
EMËR YNI MASHKULLI
SKANDALI / NATRIUM
PËREMËR PRONOR / RRIP QË SHTROHET ANËS SË OXHAKUT
FIJE E HOLLË PAMBUKU / VEND LUFTIMI I GLADIATO-RËVE
TOTENHAM
TRUP GJEOMETRIK / SHKRONJA XVIII
BASHKËTING. / AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 2
FILM I REGJISORIT AGIM SOPI / DESPOTI
TENERIFE / BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.)
PRINCIPATË ARABE (sh.shq.)
TRANS NEPTUNIAN OBJECT / I SHKALLËS MË TË ULËT A I CAKUT MË TË POSHTËM
TOKA E BUKËS / BASHKËTING.
"ANCONA"

2



LUFTËTARI .... VOKSHI
ZANORE / TEDI ALVES
SHENJA DALLUESE QË PËRFAQËSON NJË QYTET / KËNGËTARJA ANGLEZE TIKARAM
GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)
BASKETBOLL-ISTI TURK OMER .... / GOSPEL TRUTH MINISTRIES
ZANORE / MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI (shq.)
TENISTJA KURNIKOVA / KËNGËTARJA ... ZAHARIA
BUJQËSOR / EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN
HEROI PASHKO
KUNDËR / KËNGËTARJA E FAMSHME PERUANE ... SUMAK
"EVERTON" / KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI
MËNJANIM NGA GARA
SHKRONJË GREKE / ADEM DEMAÇI
SHKRONJA TË NJËJTA
VENDI KU NIS NJË RRJEDHË UJI, BURIM (sh.shq.)
BANOR I HERSHËM I NJË KRAHINE A I NJË VENDI
DANTE ALIGHIERI
KAFSHË PËR NGARKESË E VISEVE TË AMERIKËS LATINE
24 ORË

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: RAFINERI, AMA, AVORE, ORATOR, SALI, ELEMENT, ET, DIM, NAMI, LLAMARINA, OKA, AKRA, ORA, TRAM, R, RONALDO, I, ORIZI, ERMIRA, APEL, LUANI, ATI, NINA NANA, KALAT, TAKATI, RIK, KE, I, FARAD, KAI, I, KATRANI, RASIM, NAIM, SAIM, AFERA, IMI, PE, T, KON, T, ANATEMA, T, EMIRATET, TNO, ARA, ASIM, I, STEMA, RARITET, ONAN, A, ANA, AGRAR, TRENI, ANTI, EV, ELIMINIM, ETA, II, AMAT, ANAS, DA, LAMA, DITA.

# Scott Disick e ka harruar Kourtney Kardashianin



Scott Disick më në fund e ka harruar ish të dashurën, Kourtney Kardashian. Pasi u ndanë zyrtarisht në vitin 2015 pas nëntë vjetësh lidhje, Disick dhe Kardashian kanë vazhduar jetën e tyre. Disick është në lidhje me 19-vjeçaren Sofia Richie, kurse Kardashian është me Younes Bendjiman.



# Dua Lipa në mesin e 25 femrave më të fuqishme

Revista e famshme "Vogue" ka publikuar një listë me 25 femra më të fuqishme që veprojnë në Britani të Madhe dhe në mesin e tyre është edhe Dua Lipa. Këngëtarja 22-vjeçare nga Kosova është më e reja në këtë listë.

# Perrie Edwards shijon pushimet luksoze



Ajo është e njohur për linjat trupore tejet seksi. Perrie Edwards duket se ka gjetur kohë për pushime bashkë me të dashurin Andre Grey. Ajo është parë në formë të mirë me bikini të bardha derisa po shijonte pushimet luksoze në Bali.

# Aktorja Brigitte Nielsen, shtatzënë në moshën 54-vjeçare



Brigitte Nielsen ka bërë me dije se është shtatzënë dhe se së shpejti ajo dhe bashkëshorti i saj Mattia Dessi do të bëhen prindër. Aktorja 54-vjeçare tregoi këtë lajm të mirë në "Instagram" me një fotografi ku edhe shihet se sa shumë i është fryrë barku. "Familja po rritet", ka shkruar ajo.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| CZECH REPUBLIC - AUSTRALIA | 1 | |
| FRANCE - ITALY | 1 | |
| TPS - KUPS | 2 | |

# Katër gjimnaste prezantojnë Kosovën në Itali

Kosova nga sot (e premte) deri të mërkurën do të marrë pjesë në "Gold" Artistic Gymnastic Championship 2017/2018 me katër gjimnaste dhe dy trajnerë. "Nuk kemi bërë asnjë matje jashtë vendit dhe nuk e dimë se si do të shkojnë punët. Nuk e dimë se sa fëmijë do t'i kalojnë emocionet e pjesëmarrjes në këtë garë dhe t'i prezantojnë ashtu siç duhet elementet e përgatitura. Besoj se paraqitja do të jetë e mirë. Nuk e përjashtoj mundësinë e fitimit të ndonjë medalje", ka thënë trajneri Shkumbin Maqastena

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 31 MAJ - Gjimnastet Bora Hoti, Amela Gërbeshi, Vilëza Zeqiri dhe Valëza Rama, të udhëhequra nga trajneri Shkumbin Maqastena dhe trajnerja me përvojë ndërkombëtare Abeliana Bregu, do ta shkruajnë historinë e re në sportin e gjimnastikës së Kosovës, pasi për herë të parë, pas konsolidimit të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, do të marrin pjesë në një garë ndërkombëtare. Në fakt, këto vasha do ta përfaqësojnë Kosovën në garën "Gold" Artistic Gymnastic Championship 2017/2018 që mbahet nga data 1 deri më 3 qershor në Romë të Italisë. Ftesa për pjesëmarrje ka ardhur nga Asociacioni Sportiv Sociali Italiane në Federatën e Gjimnastikës së Kosovës.

Trajneri Shkumbin Maqastena për "Epokën e re", ka thënë se ndihet i lumtur që Kosova do të marrë pjesë në një ngjarje kaq të rëndësishme ndërkombëtare. "Është e mirëseardhur pjesëmarrja në Itali, pasi që prej pavarësimit të sportit Kosova nuk ka prezantuar diçka të mirëfilltë jashtë vendit. Është diçka e madhe që pas një viti e gjysmë punë të marrim pjesë në kampionatin e gjimnastikës të organizuar nga Consport Italia", ka thënë Maqastena, i cili ka falënderuar Federatën e Gjimnastikës së Kosovës dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbështetjen e dhënë. "Kemi mbështetje financiare dhe morale nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës, edhe prej Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që e ka kryer si duhet punën rreth pajisjes me viza. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj ministrin e MKRS-së dhe kryetarin e FGjK-së për punën që kanë bërë", ka deklaruar ai.



Edhe pse kjo është hera e parë që gjimnastet dalin në arenën ndërkombëtare pas konsolidimit të Federatës së Gjimnastikës, trajneri Maqastena beson paraqitje dinjitoze, pse jo edhe medalje. "Nuk kemi bërë asnjë matje jashtë vendit dhe nuk e dimë se si do të shkojnë punët. Nuk e dimë se sa fëmijët do t'i kalojnë emocionet e pjesëmarrjes në këtë garë dhe t'i prezantojnë ashtu siç duhet elementet e përgatitura. Besoj se paraqitja do të jetë e mirë dhe nuk e përjashtoj mundësinë e fitimit të ndonjë medalje", ka shtuar Maqastena.

Për pjesëmarrjen e katër gjimnasteve të reja, Bora Hoti, Amela Gërbeshi, Vilëza Zeqiri dhe Valëza Rama, në garën që zhvillohet në kryeqytetin italian, foli edhe kryetari i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës (FGjK), Besim Halilaj. Ky i fundit, ashtu sikurse trajneri Shkumbin Maqastena, është optimist se këto garuese do të prezantohen në mënyrën më të mirë në Itali. "Kjo është hera e dytë që Kosova merr pjesë në gara ndërkombëtare, pasi për herë të parë Federata e Gjimnastikës u prezantua në Gjeorgji me dy gjimnaste, por atëherë nuk është pritur se do të kemi ndonjë rezultat. Kemi marrë ftesë të prezantohemi me katër garues dhe dy trajnerë. Është një ndjenjë e veçantë, për faktin se sporti që përfaqëson ka mundësinë të prezantohet edhe jashtë vendit. Shpresojmë më të mirën e mundshme në këtë garë. Jemi duke punuar si federatë që t'i krijojmë kushte sa më të mira klubeve për t'u përgatitur për gara. Trajnerët që do të udhëtojnë në Itali po bëjnë një punë profesionale dhe besojmë të paktën në prezantim të denjë. I ftuar kam qenë edhe unë si kryetari i FGjK-së, por kam shumë punë këtu dhe nuk mund të udhëtoj", ka deklaruar Halilaj.

# Prishtina prezanton Thaqin dhe Bekteshin

PRISHTINË, 31 MAJ - FC Prishtina, pas Ahmet Halitit nga Feronikeli dhe Meriton Korenicës nga Liria, sot ka realizuar edhe dy transferime të tjera nga skuadra e Gjilanit. Kryeqytetasit e kanë rikthyer në skuadër mbrojtësin Armend Thaqi, kurse transferimi tjetër është Leutrim Bekteshi. "Vendosa të rikthehem për shkak të kushteve të ofruara dhe pjesëmarrjes në kupat e Evropës. Prishtina ka qenë, sidomos tash do të jetë ekip jashtëzakonisht i mirë. Pres t'i vazhdojë paraqitjet e mira. Skuadra ka trajner që është i dëshmuar edhe në kupat e Evropës dhe kuptohet së bashku kemi qëllim që ekipi të ketë paraqitje sa më të mirë në Evropë dhe ta rikthejmë titullin e kampionit", ka thënë Thaqi për faqen zyrtare të Prishtinës. Ndërsa mbrojtësi Leotrim Bekteshi, i cili ka luajtur edhe për Besën e Pejës, ka thënë se do ta japë maksimumin për fanellën "bardhekaltër" në mënyrë që ta shpërblejë besimin e dhënë nga skuadra e Prishtinës. "Jam shumë i lumtur që kam arritur marrëveshje për dy vjetët e ardhshëm me Prishtinën. Besoj shumë se do t'i arrijmë objektivat e klubit, që dihen cilat janë, gjithmonë vetëm trofetë. Jam shumë i kënaqur me kushtet e ofruara dhe premtoj se do ta jap maksimumin nga vetja që ta shpërblej besimin e ofruar", ka thënë Bekteshi.



## Magani përforcon Feronikelin

